

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
 Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA
 Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7652 E shtunë 15 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje
 në "Deutsche Welle"
Rusia dhe Kina po zhvillojnë në Rajonin e Siberisë një stërvitje ushtarake nga më të mëdhatë, që nga koha sovjetike, apo që nga viti 1981. Njoftohet se në këtë...
 Vijnë në faqen 21-22

Nga VASIL KURETA
Pse tani dhe cila është domethënia e demonstrimit ushtarak ruso-kinez?


Opinion
Ditës
Jemi përbetuar që me shqiptarët e Kosovës përbëjmë një të vetme se Kosova është Shqipëri e Shqipëria është Kosovë. Nga ana shpirtërore e besoj që kështu është...
 Vijnë në faqen 22

Nga LILIANA HOXHA
Shqiptarët e Shqipërisë dhe Kosova



Nipi: Xhaxhai u plagos me plumb në ballë, të zbardhet ngjarja

Policia mësyr në zonën e Divjakës, plagoset 77-vjeçari: Na doli me armë

Shpëtojnë për herë të 14 Laert Haxhiu e Orges Bilbili.
 Plagoset gjatë operacionit banori që dyshohej se i strehonte
 LUSHNJE - Në orët e para të mëngjesit të djeshëm, forcat operacionale të Policisë së Shtetit, RENEA dhe FNSH kanë zbarkuar në fshatin në Remas të Divjakës, në një operacion për kapjen e të shumëkërkuarve Laert Haxhiu dhe Orges Bilbili, të dy persona të njohur me rekorde kriminale dhe autorë të dyshuar të masakrës së 11 shtatorit...

TOKAT E ZENA NGA NDERTIMET PA LEJE, PRONARET MARRIN 70% TE VLERES

PRONAT, SI DO TE NDAHEN 313 MLN LEKE KOMPENSIM

Lista me përfituesit në Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër dhe Elbasan. Dokumentet që duhen dorëzuar në Agjencinë e Trajtitimit të Pronave për të marrë paratë

Data Ndarjes	Mëdha/numri i zonës/projektit				Qyteti
	Emri	Adresa	Mëdha/numri	Çmimi	
20.01.2018	SHALLI	MTEN	SHALLI	TIJANË	TIRANË
20.01.2018	HALÇI	ZIJEV	LIQUR	TIJANË	TIRANË
20.01.2018	BLINÇI	REAP	MALINÇI	TIJANË	TIRANË
20.01.2018	FRANÇO	AKIL	TRILANÇI	TIJANË	ELBASAN
20.01.2018	FLU	MUSTATA	BARASANI	TIJANË	TIRANË
20.01.2018	MIRANÇI	SHINO	KASANI	TIJANË	TIRANË
20.01.2018	FRANÇI	EDMONDO	BARASANI	TIJANË	TIRANË
20.01.2018	DIJAL	BARASANI	SHINO	TIJANË	TIRANË
20.01.2018	MET HAT	DIJAL	SHINO	TIJANË	TIRANË
20.01.2018	SHIRANÇI	PELLAN	SHINO	TIJANË	TIRANË
20.01.2018	ELJA	PELLAN	SHINO	TIJANË	ELBASAN
20.01.2018	EMANÇI	NALIM	SHINO	TIJANË	TIRANË
20.01.2018	BARASANI	ARIBI	METALI	SHINO	TIRANË
20.01.2018	HEL	NOÇI	VARUKA	SHINO	TIRANË
20.01.2018	ARIBI	FLU	NOÇI	TIJANË	TIRANË

(Në foto) Foto ilustruese. Faksimile e listës së përfituesve në Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër dhe Elbasan

DENONCIMI I PD
Aferat me tenderat, Basha: 229 milionë euro shkuan për luks qeveritar
 Në faqen 3

TAKIMI
Rama: Do heqim celularët për mësuesit e administratën, u bënë si klube interneti
 Në faqen 4

MASA E SIGURISE
"Toyota"-t me 3.4 mln euro, Klevis Lika kërkon lirinë. Flet avokati
 Në faqen 6

LISTA E RE
KEMP-i, emrat e 308 personave që do të kryejnë kontroll mjekësor
 Në faqen 12

GREQI
Lejet e qëndrimit, nis aplikimi i tarifave të reja për shqiptarët
 Në faqen 9

BLUE TOOTH Alketa Vejsiu, rrëfhet moderatorja: "Dance with me 5", ja surprizat **Erioni dhe Ajola, në pritje të një djali**
 Në brendësi: Iva Aliko, ish-e dashura e deputetit publikon fotot provokuese

Nga PAMELA ALIAJ
 Jo më larg se para një jave në Amfiteatrin e Tiranës është organizuar një mbrëmje speciale në nder të 30-vjetorit të krijimit të "Elita 5". Me pjesëmarrjen e një grupi vërtet elitar, koncerti ka qenë madhështor e ka mbledhur



rreth vetes admiruesit e muzikës së grupit të njohur ku të gjithë kanë shijuar tingujt e hiteve ndër vite. Në koncert nuk kishin se si të mungonin edhe kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj me bashkëshorten e tij. Ka qenë pikërisht ai që...

Suplement

SITUATA POLITIKE

AKUZAT

Valentina Madani

Parti Demokratike akuzon kryeministrin Edi Rama dhe ministrin e Brendshëm Fatmir Xhafaj se kanë përdorur pushtetin politik për të fituar dhe pas-truar paratë e krimit dhe të drogës përmes lojërave të fatit. Deputetët e Partisë Demokratike, Enkelejd Alibeaj dhe Jorida Tabaku, dolën përpara mediave, duke deklaruar se "pikat e basteve në pronësinë e Agron Xhafajt dhe me mbështetjen politike të Fatmir Xhafajt kanë shumëfishuar aktivitetin e tyre". Ata publikuan një grafikë ku sipas PD-së tregohet se shtimi i pikave të bixhozit ka nisur gjatë operacionit "Fundi i marrëzisë", duke vazhduar me periudhën kur Fatmir Xhafaj bllokoj ligjin për llogaritë grupit kriminal Xhafaj. "Fatmir Xhafaj me vëllanë e tij Agron Xhafaj, dhe Edi Rama me vëllanë e tij Olsi Rama ortak në kompaninë e koncesionit korruptiv të lojërave të fatit janë provat e qarta si funksionon në praktikë lidhja mes pushtetit dhe krimit të organizuar që kontrollon lojërat e fatit. Koncesioni i monitorimit online të pikave të basteve i siguron Olsi Ramës miliona euro fitim, sepse i vëllai kryeministër detyron me ligj pikat e basteve të bëjnë pagesën e mirëmbajtjes së sistemit të kompania monopol e tij, që pastron paratë e krimit të organizuar dhe korrupsionit", tha z.Alibeaj. Duke iu referuar vendimit të gjykatës italiane për të dënuar vëllain e ministrit të Brendshëm Fatmir Xhafaj, Agronit si pjesëtar të një organizate kriminale në Itali, Alibeaj përmendi edhe emrat e Besnik e Gramoz Muratajt. Ai tha se ata rezultojnë të dënuar në Itali dhe i etiketoi si pjesëtarë të bandës së Agron Xhafajt. Por pavarësisht kësaj tha Alibeaj ligji antimafia nuk ka vepruar për këta dy persona, që rezultojnë të jenë pronarë të dy kompanive të basteve në Shqipëri. "Bashkëpunëtorët e Agron Xhafajt, vëllezërit Muratajt janë sot pronarë të dy kompanive të basteve dhe njëra prej tyre është ndër më të njohurat dhe shfaqet me disa emra. Për këtë dy të dënuar duhet të kishte vepruar ligji antimafia për të verifikuar burimin e pasurisë së tyre. Deri tani ligji nuk ka vepruar, sepse anëtarët e bandës së Agron Xhafajt është vetë, fasa-

PD: Anëtarët e bandës së Agron Xhafajt zotërojnë 2 kompani bastesh në Shqipëri

Tabaku e Alibeaj: Rama e Xhafaj shumëfishuan lojërat e fatit

"Klani që kontrollon sektorin e basteve"



Deputetët e Partisë Demokratike, Enkelejd Alibeaj dhe Jorida Tabaku

AKUZAT

PD shprehet se dy bashkëpunëtorë të Agron Xhafajt janë pronarë të dy kompanive të basteve, të cilët kanë shumëfishuar aktivitetin në tregun e bixhozit. Gjithashtu, edhe pse janë të dënuar ndaj tyre nuk ka vepruar ligji i antimafias.



Gjatë një seance parlamentare

PD, Boçi: Mësuesit përdoren për aktivitetet e Ramës

Deputeti i Partisë Demokratike, Luçiano Boçi, denoncoi dje përdorimin e mësuesve, sipas tij, në aktivitetet e kryeministrit Rama. Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", deputeti Boçi thotë se mësuesit "janë selektuar dhe lajmëruar për të qenë pranë DAR-ëve". "Kryeministri që rremben mësuesit. Ka ngjarë sot (dje)!" Kryeministri ka "rrembyer" me zor mësuesit. Si shkuese-ndërmjetëse ka përdorur si gjithmonë Nikollën. Mësuesit janë selektuar dhe lajmëruar për të qenë pranë DAR-ëve. Aty janë gendur para rrëmbimit. I kanë marrë peng e i kanë hipur në autobusë me pahir për në Tiranë, pa asnjë njoftim të mëparshëm. Sepse paskan një takim "të ngrohtë" me rrëmbësin-Ramë. Ehhh si ka shkuar kjo punë?! Dikur rrëmbimet bëheshin nga dashuria, tani bëhen nga urrejtja. N.q.s. ka një kategori që kryeministri e urren me shumë, këto janë mësuesit. Çfarë nuk i ka bërë?! E megjithatë përsëri i rremben. I merr me zor t'i tregojë përrallat e mashtrimeve të përvitshme", shprehet deputeti i PD-së.

"Komprometim i hapur, kjo nuk është drejtësi"

Audiopërgjimi i vëllait të Xhafajt, Vasili: Arta Marku, mburojë e Ramës



BUJAR NISHANI

Ish-presidenti Bujar Nishani teksa ironizon me fushatën e qeverisë për librat falas, shkruan se ato nuk ka kush t'i marrë, pasi shkollat po mbyllën e fëmijët me familje po largohen nga vendi pas mungesës së shpresës.

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së Petrit Vasili akuzon kryeprokuroren Arta Marku se është bërë mburojë e kryeministrit Rama, pasi nuk ka bërë asgjë për padinë ndaj shefit të qeverisë lidhur me audiopërgjimin e vëllait të ministrit Fatmir Xhafaj. "Arta Marku mburojë e kryeministrit të paditur, kjo është zgjyrë dhe jo drejtësi. Që në 11 korrik kryeministri është i paditur në prokurori, sepse mashtroi publikisht popullin shqiptar lidhur me audiopërgjimin e vëllait të ministrit të brendshëm kur ai vetë përpara grupit parlamentar të PS deklaroi publikisht: "Kam marrë mbremë përgjigjen e analizës shkencore nga një prej laboratorëve më të mirë në botë. Ajo provë më mjafton për t'ju thënë juve se nuk jemi përpara një prove komprometuese ndaj ministrit. Jemi përpara një materiali jo autotënik që synon destabilizimin". Në zbatim të

ligjit PD dhe LSI iu drejtuan prokurorisë që të hapë hetim penal ndaj kryeministrit, ndaj Edi Ramës, për pengim të së vërtetës, për fshehje të së vërtetës, duke mos dorëzuar provën në fjalë, ekspertimin që ai ka bërë në një periudhë aq të shkurtër në një nga laboratorët më të mirë të botës.

da që fsheh pronësinë reale të Agron Xhafajt mbi këtë kompani: Ekoped, etj. nën pronësinë e Agron Xhafajt dhe me mbështetjen politike të Fatmir Xhafajt, për 5 vjet ka shumëfishuar aktivitetin në tregun e bixhozit", u

shpreh deputeti i PD-së. Kurse deputetja demokrate Jorida Tabaku deklaroi se ndryshe nga sa qeveria tha për mbylljen e pikave të basteve, ka ndodhur e kundërta. "Dy njerëzit më të pushtetshëm të vendit kanë ofruar mundësi

korruptive dhe mbrojtje politike për vëllezërit e tyre, Olsi Rama dhe Agron Xhafaj, në fushën e lojërave të fatit", deklaroi Jorida Tabaku nga selia e PD-seku nisi të argumentonte akuzat e argta. "Mbështetja e Ramës me Xhafajn katër-

kryeministrit e kupton çdo shqiptar, kryeprokurori ja po rëndon keqas veten me këtë komprometim të hapur publik në mbrojtje të kryeministrit. Sigurisht koha për t'u përballur me këtë përgjegjësi ka ardhur edhe për kryeprokuroren", - shkruan Vasili.

fishoi pikat e basteve nga 920 në 4200. Sot në Tiranë e në të gjithë Shqipërinë ka më shumë pika bastesh sesa dyqane ushqimore dhe libra. Shumë prej tyre kanë lidhje me klanin mafioz Xhafaj. Negociata sekrete

midis Xhafajt dhe ministrit të Financave prodhojnë ndryshimet më të mëdha që favorizojnë biznesin e bixhozit, jo gjatë diskutimeve 8 mujore, por në seancën plenare gjatë miratimit të tij", deklaroi zj.Tabaku.



Kreu i PD denoncon me video korrupsionin e qeverisë "Rama", mesazhi për shqiptarët

Aferat me tenderat, Basha: 229 milionë euro për luks qeveritar

"Sa më gjatë kjo qeveri, aq më shumë korrupsion"

Valentina Madani

Kreu i PD-së, Lulzim Basha denoncoi dje me video rrënimin e ekonomisë dhe vendit, duke akuzuar për këtë direkt kryeministrin Edi Rama dhe korrupsionin e qeverisë së tij. Me një video të postuar në faqen e tij në "Facebook", Basha tregon me fakte se çfarë po ndodh më ekonomisë e vendit dhe si po varfërohen çdo ditë shqiptarët. Teksa sulmon kryeministrin Edi Rama, lideri i PD-së thekson se shkak është bërë korrupsioni i kësaj qeverie. "Shqiptarët varfërohen çdo ditë nga korrupsioni i qeverisë 'Rama'", - shkruan Basha, duke numëruar aferat me tenderat, 229 milionë eurot që kanë shkuar për luks qeveritar. "Sa më gjatë kjo qeveri, aq më shumë korrupsion, aq më i varfër populli", - thuhet në videon e publikuar nga z.Basha.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

DENONCIMI

"Shqiptarët varfërohen çdo ditë nga korrupsioni i qeverisë 'Rama'", - shkruan Basha, duke numëruar aferat me tenderat, 229 milionë eurot që kanë shkuar për luks qeveritar. "Sa më gjatë kjo qeveri, aq më shumë korrupsion, aq më i varfër populli", - thuhet në videon e publikuar nga z.Basha.

"Diskutuam për nismat e marra nga PD"

Afrimi i Idrizit me PD, Dule takon Bashën: Shikojmë interesat tona

PBDNJ do të vazhdojë të jetë në një koalicion me PD. Deklarata u bë dje nga kreu i kësaj partie, Vangjel Dule, vetëm pak ditë pasi PDIU vendosi të negociojë me selinë blu për një koalicion. Dule takoi dje kreun e PD-së, Lulzim Basha. Ai tha se janë analizuar qëndrimet dhe nismat e marra nga PD dhe aleatët. "Pas një mungese të shkurtër nga ana ime, ishte i domosdoshëm takimi për të analizuar qëndrimet dhe nismat e marra nga PD dhe aleatët e vet. Rrjedhimisht, në një axhendë të tillë është kuptueshme që temat për diskutim ishin të shumta. PBDNJ është një parti me një profil të theksuar që në aktivitetin e vet politik karakterizohet nga konsekuenca në atë sistem vlerash dhe parimesh që nga themelimi i saj dhe për rrjedhojë nuk besoj se ka për interpretime përtej asaj tradicionales. Në jetën politike, Vangjel Dule nuk ka asnjë kuptim nëse nuk është në shërbim të një platforme të caktuar, idealesh, vlerash



ALEANCAT

Brenda kësaj jave kryedemokrati Basha pritet të mbyllë një takim edhe me rivalin e Dules, Shpëtim Idrizin. Në rast se minoritarët largohen, opozita do të humbasë një deputet, ndërsa afrimi i çamëve të Idrizit nuk i sjell asnjë favor në sallën e parlamentit.

dhe parimesh", theksoi z.Dule. Lëvizjet e reja në skenën politike bënë që në zyrën e kryedemokratit të trokiste të premtën vetë kreu i PBDNJ-së për të qartësuar pozicionet. Por, për sa kohë aleanca e re PD-PDIU ende nuk është zyrtare, Dule u tregua evaziv në deklarata, duke ia lënë kohës një qëndrim përfundimtar. "Flasim për një axhendë politike aktuale, jo për hamendësime. PBDNJ është një parti që ka prioritetet e veta. Për aq kohë sa prioritetet e veta kryesore janë në afinitet me

një forcë tjetër politike, natyrisht që vazhdon bashkëpunimi. Që nga momenti që nuk ekziston kjo bazë e realitetit të zhvillimeve politike, atëherë mungojnë premisat për një gjë të tillë", u shpreh Dule. Brenda kësaj jave kryedemokrati Basha pritet të mbyllë një takim edhe me rivalin e Dules, Shpëtim Idrizin. Në rast se minoritarët largohen, opozita do të humbasë një deputet, ndërsa afrimi i çamëve të Idrizit nuk i sjell asnjë favor në sallën e parlamentit.

Moses-Ones. PD, krenare për miqësinë dhe bashkëpunimin me SHBA, partnerin strategjik të Shqipërisë dhe kombat shqiptar. "Takim lamtumire me ambasadorin Donald Lu dhe mirëseardhje me zv. ambasadorin Leyla

dentin Ilir Meta, ish-kryeministrin Sali Berisha, kryetaren e LSI-së, Monika Kryemadhi; ambasadori Lu iu drejtua paraditen e djeshme selisë së PD-së, për t'u përshëndetur edhe me

kryedemokratit Basha. Takimi në fjalë zgjati rreth 1 orë e gjysmë. Kujtojmë se Lu vijoi mandatin e tij për 4 vite në Shqipëri, ndërsa tashmë do të zëvendësohet nga Kathleen Ann Kavalec.

Vetingu në politikë, Ruçi: S'ka gjë të re, është diskutuar edhe në të kaluarën

Kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi foli dje për vetingun në politikë, pas propozimit që PD ka dorëzuar disa ditë më parë. Nga Fieri, ai tha se drafti është botuar në faqen zyrtare të Kuvendit. Kujtojmë se një ditë më parë, kryedemokrati Basha i bëri thirrje kryeparlamentarit Ruçi që të nisnin procedurat për këtë projektligj. "Ka ditë që ky draft është paraqitur. Sipas procedurave parlamentare, dje ka qenë afati për të njoftuar seancën e parlamentit. Është futur në programin e Kuvendit. Është botuar në faqen e Kuvendit. Pas dy javësh nga data e depozitimit do të mblidhet Këshilli i Legjislacionit dhe Komisioni i ligjeve që do të bëjë një program për njohjen, diskutimin dhe për materialin dhe më pas do të cohet për diskutim. Do të miratohet apo jo, është shumë shpejt për të dhënë një vendiktin. Jam kryetar i parlamentit dhe drejtues i saj. Vetingu për politikanët është diskutuar në të kaluarën, qoftë në vitin organik, i cili miratoi me konsensus ligjet për dekriminalizimin, ashtu si pjesë e vetingut janë objekt i reformës në drejtësi. Presim nisma, drafti është në tavolinën e diskutimit. Do të diskutohet dhe gjykohet në momentin e duhur", tha kryeparlamentari Ruçi.

Salianji: Policia e tredhur nga krimi, të vret edhe në gjumë

Deputeti i PD-së, Ervin Salianji, reagoi dje përmes një postimi në "Facebook", në lidhje me aksionin e RENEAs në Lushnjë, ku mbeti i plagosur një i moshuar. "Këta të cilin policia sot është e tredhur nga krimi. 'Drejtuesit e policisë së tredhur nga krimi dhe të përdorur politikisht nga aleatet e kimit në qeveri, të pafuqishëm për të luftuar krimin dhe bandat bëjnë show' me sirena dhe RENEA nëpër fshatrat e Shqipërisë. Sot që Policia e Shtetit nuk zbulon autorët e krimeve, por i fshih ata, gjen kohën për të goditur në gjumë një të moshuar 77-vjeçar në fshatin Remas të Lushnjës. Po aq kriminale sa ngjarja është shtrembërimi i së vërtetës nga policia dhe përpjekja për ta shiur si operacion kundër kimit", shprehet z.Salianji. Në vijim Salianji publikoi edhe fotot brenda banesës, të cilat shkruan ai, tregojnë qartë që i moshuari është goditur brenda shtëpisë, në krevat, nga distanca e largët çka e rrëzon pretendimin e policisë. "Prandaj çlirimi i qeverisë nga kthetrat e kimit nëpërmjet vetingut është mision historik. Policia duhet të jetë në shërbim të qytetarëve, jo kundër qytetarëve dhe në ndihmë të kimit!", - shprehet deputeti demokrat.

MËSUESIT QEVERIA

Kryeministri me mësuesit fitues të "Portalit": Nuk mund të biem në hakmarrjet e politikës

Kryeministri Edi Rama bëri të qartë dy ditë para fillimit të shkollës se mësuesit e nxënësit nuk do të mbajnë celularë gjatë procesit mësimor. Gjatë takimit me mësuesit që u emëruan në arsim përmes portalit 'Mësues për Shqipërinë' deklaroi se ata do i marrin kur të largohen. Një nisim e tillë shtoi kryeministri, do të shtrihet më pas edhe në institucionet shtetërore, pasi sipas tij janë bërë si klube interneti. "Ky vit do të jetë viti i një epoke të re në raport me celularin në shkollë. Nuk do lejojmë celularë në shkollë, as për fëmijët dhe më vjen keq, as për mësuesit. Mësuesit do duhet t'i dorëzojnë në fillim të mësimit dhe t'i marrin në fund të mësimit. Muajin e parë duhet ta bëjmë muaj edukimi. Nga muaji i dytë, celularët merren dhe hidhen në plehra. Nuk i kthehen më atij që e ka, sepse janë ndotës të rrezikshëm të mjedisit arsimor. Çfarë bëjmë me lëndët ndotëse me rrezikshmëri të lartë? I varrosim dhe i riciklojmë, nuk ua kthejmë mbrapsht. Njerëzve u themi, vazhdoni përdorini, por jo këtu.

Jam i bindur që ky do jetë një ndryshim i madh. Ndërkohë po përgatitemi edhe për vendimin që të heqim celularët nga institucionet e shtetit, që janë bërë si klube interneti, të gjitha", u shpreh Rama.

Gjatë fjalës Rama foli për një mesazh që ai e kishte parë aty në sallë, por që e njihje nga koha kur kishte qenë kryetar bashkie. "Nuk ka lënë gjë pa bërë që unë të mos fitoja zgjedhjet. Por ç'rëndësi ka kjo! E ka bërë si një qytetarë e Tiranës, që nuk ka dashur të më shikojë me sy, me të drejtën e vet, ndërkohë që është një mësuese, e cila nxënësve u jep atë që duhet dhe detyrën e saj si mësuese e kryen më së miri. Si ka mundësi që të mund të biem në kurthin e hakmarrjes, siç ramë për çerekshkulli, duke i kthyer mësuesit si mish për topat e politikës! Duke bërë që asnjë mësues, asnjë mësuese në Republikën e Shqipërisë të mos ndjehej i sigurt, apo e sigurt për vendin e punës. Duke bërë që të gdhieshe të nesërmen, e degdisur në një shkollë tjetër, pasi ishe ngrysur në një shkollë tjetër, jo për arsye të dijeve të tua, as për arsye të ndonjë vlerësimit të dijeve, por thjesht dhe vetëm për arsyen e mos arsyen së politikës,

Rama: Do heqim celularët për mësuesit e administratën, u bënë si klube interneti

Kthimi i librave, penalitetet janë për prindërit



Kryeministri Edi Rama

LIBRAT

"Libri është miku më i mirë, fëmijët e kuptojnë, por jo prindërit. Zhgarravitja e librit u duket liri, ruajtja diktaturë, nuk është çështje lekësh. Është lidhja me atë objekt që i flet mendjes, zemrës dhe të bën të dalosh nga të tjerët. Penalitetet për atë që nuk kthejnë librat janë për prindërit, jo për fëmijët. Janë për këta që stresohen", - u shpreh Rama.

"Ministria e Jashtme, me performancën më të ulët"

Raporti i 'Mjaft'-it, transparenca e qeverisë në rënie, renditet e 4-ta në rajon

Transparenca dhe llogaridhënia e qeverisë shqiptare ka pësuar përkëqim nga viti i kaluar me një rënie prej 3% duke u renditur e katërta në vendet e rajonit. Të gjitha qeveritë e Ballkanit kanë paraqitur regres në nivele të ndryshme të përfundimit të Maqedonisë. Madje sipas raportit të rrjetit të organizatave të Shoqërisë Civile në vendin tonë qeveria shënon shifrat 0% të transparencës kur flitet për vepërimtari që lidhen me paratë e shtetit. "Të gjitha qeveritë e rajonit kanë paraqitur regres në nivele të ndryshme, me përfundim të



Maqedonisë. Në kuadër të hapjes dhe transparencës në renditimi të katërt në rajon. Një nga problemet që është vënë re është mungesa e stafit të kualifikuar dhe të njohura me politikën e transparencës", - u shpreh Aldo Merkoçi i Lëvizjes MJAFIT. Por përveç ekzekutivit, edhe ministratë në krahasim me

vendet e rajonit kanë mungesë transparence dhe performancë të dobët, duke lënë pas vetëm Bosnjë-Hercegovinën dhe Kosovën. "Ministria, e cila ka rezultuar me performancën më të mirë është ajo e Kulturës, ndërsa performancën më të ulët e ka ministria për Europën dhe Punët e Jashtme", tha Merkoçi. Gjithashtu, sipas këtij raportit, 29% e institucioneve të ekzekutives nuk kanë një website. Ndërsa Agjencia e Mbikëqyrjes së Faliimentit dhe Agjencia Rajonale e Sistemit Shëndëtor kanë performancën më të dobët me 0% të hapjes institucionale.

duke bërë që të ishte në dispozicion sa herë duhej mbushur një sallë për mitingje", - u shpreh Rama. Sipas Ramës "300 nxënës të ekselencës, që sot janë regjistruar për t'u bërë mësues, janë garancia më e madhe për t'ju

tënë të gjithëve, që po, reforma jonë ka filluar të funksionojë dhe Shqipëria që duam, nesër do të jetë 1000 herë më e mirë se Shqipëria që kemi sot. Ndërkohë, ajo që kemi sot është 1000 herë më e mirë se ajo që kishim dje për

të gjithë ju". "Për të 300 nxënësit e ekselencës që do të fillojnë të studiojnë për t'u bërë mësues, ne do të paguajmë të gjitha shpenzimet. Nuk do të kenë asnjë qindarkë shpenzime për tarifën e universitetit, sepse mësues-

Niset "Lasgushi", avioni i parë i "Air Albania", Rama: Nisi një epokë e re

Avioni i parë i "Air Albania", kompania e parë ajrore shqiptare, u ul dje, në aeroportin e Rinasit, Airbus 319, që si stemë ka flamurin shqiptar. Gjatë ceremonisë së uljes së avionit të parë "Lasgushi" të kompanisë shqiptare "Air Albania" kryeministri Edi Rama, theksoi se kompania "Air Albania" do të jetë një "çelës" në përmirësimin e objektivit, që brenda vitit 2025 Shqipërinë ta vizitojnë 10 milionë turistë. "Bëhet fjalë për një fluturim të qëndrueshëm e të vazhdueshëm, që do t'i japë mundësi kësaj kompanie që të jetë "çelës" jo vetëm në funksion të një shërbimi dinjtoz për shqiptarët që kanë dhe mbeten të detyruar që të fluturojnë me avionë të plakur dhe me shërbim krejtësisht të pamërituar, por edhe si një "çelës" të strategjisë tonë të zhvillimit të turizmit, në funksion të objektivit për të arritur në 10 milionë turistë deri në vitin 2025. "Air Albania" është një ndërmarrje e mundimshme, sepse është dashur dhe nuk diskutohet, që pa iniciativën dhe mbështetjen bujare të Presidentit Erdogan, ne nuk do të ishim këtu dhe pas marrjes së këtij vendimi rruga nuk ka qenë e lehtë. Dëshmitarët që kam në krah mund të tregojnë shumë nga u nisim kur aplikuan dhe as që e kanë imagjinuar që sa shpejt do të vinte kjo ditë, që do të ishin të veshur me kostumet e kompanisë sonë të flamurit kuqezui", - theksoi Rama. Në gërmor të këtij viti, qeveria nisi procedurën për krijimin e shoqërisë "Air Albania". Duke folur për çmimet e larta të biletave të avionëve, kryeministri tha: "Unë i dëgjoj kërkesat e shqiptarëve për çmimet e biletave. Janë në të drejtën e tyre që gjithë atë mllëf që akumulohet nga kjo grabitje që u bëhet ta derdhin mbi qeverinë dhe ta derdhin mbi mua. Nga ana tjetër kjo është kostoja e trashëgimisë që kemi mbi supet dhe nga e cila po çlirohemi hap pas hapi. "Air Albania" është një nga instrumentet për t'u çliurur nga kjo trashëgimi me një shërbim dinjtoz dhe çmime konkurruese. Ashtu si ndërtimi i aeroporteve të tjera çon në këtë rrugë", - tha Rama.



it, nga figurantët e mitingjeve të politikës, janë dritën në syrin e politikës sonë", - u shpreh kryeministri. Sa i përket kthimit të librave, Rama tha: "Ndërkohë sistemi ka nevojë të konsolidohet, për të kuptuar ekzaktesisht se si do

të jenë penalitetet për ata që nuk kthejnë librat. Penalitetet nuk janë për fëmijët, janë për prindërit. Janë për këta që stresohen, për këta që me siguri janë kundër që fëmijëve t'u heqim celularët", - tha Rama.

SH.PALLJE ANKANDI
Data 21.09.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com

Sigilli ankandin e dytë për pasuritë e paluajshme të dorëzuanesve Petrit Sami Sina dhe Majlinda Xhavit Sina:

"Aparamenti" me sipërfaqe 54 m2, me nr. pasurie 11/26+1-7, zona kadastrale 2932, vol. 14, faqe 26, adresë: Lagja "Gjokë Dogi", Peshkopi, Dibër.

Cmimi lilestar i ankandit të dytë është në shumën 1 120.000 (një milion e njëqind e njëzet mijë) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientin e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

Përmbaruesi Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, njofton shpalljen për shitje në ankand të Tretë për pasuritë e paluajshme si më poshtë;

- Pasuria nr. 250/3+1-2, Vol.-31, fq.-234, Z.K-1791, Apartamenti me Sip.-209.7 m2, në vlerën 4756 000 (Katër milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë.

- Pasuria nr. 250/3+1-3, Vol.-31, fq.-235, Z.K-1791, Apartamenti me Sip.-209.7 m2, në vlerën 4756 000 (Katër milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë.

- Pasuria nr. 210/11, Vol.-4, fq.-201, Z.K-1791, Illoj/Ani me Sip.-500 m2, në vlerën 252'000 (Dyqind e pesëdhjetë e dy mijë) Lekë.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 03.10.2018, në orën 16.00, në ambientin e zyrës së Përmbaruesit Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, me adresë; Rruga "Urani Pano", Pll.-1/3, Kati -2, Tiranë. Cel. 069 73 23 003, email; medar.kajolli@yahoo.com

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

A. Pasuria nr. 26/ 319, e Illojt 'truall', vol. 27, fq. 207, zk. 8642, sip. 10.000 m2, ndodhur në Sarandë, në pronësi të GRIGOR TAVO;

B. Pasuria nr. 26/ 320, e Illojt 'truall', vol. 27, fq. 208, zk. 8642, sip. 10.000 m2, ndodhur në Sarandë, në pronësi të GRIGOR TAVO;

ÇMIMI 78.976.000 LEKË për secilin pasuri; në Total 157.952.000 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë **26.09.2018**.

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .



Ministri i Jashtëm takon autoritetet kosovare: Unitet e solidaritet

Bushati: Dialogu Kosovë-Serbi, procesi të vijoje me durim strategjik

Pacolli: Mos e harroni Kosovën, kemi nevojë për Shqipërinë

Darina Tanushi

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtë Ditmir Bushati u sugjeroi autoriteteve të Kosovës të vijojnë dialogun me durim strategjik. Bushati ishte dje, për një vizitë zyrtare në Kosovë, pas takimeve që pati në Maqedoni. Ministri Bushati u takua me kryetarin e parlamentit të Kosovës Kadri Veseli, me kryeministrin e Kosovës Ramush Haradinaj, zëvendëskryeministrin e parë, njëherësh ministër i Punëve të Jashtme të Kosovës Behgjet Pacolli, si dhe përfaqësues të spektrit politik në Kosovë. Në takimin me kryetarin e parlamentit të Kosovës Kadri Veseli u diskutua



që Kosova është gjithmonë e para dhe kësaj devize besoj se i jemi përmbajtur me besnikëri pavarësisht pozicioneve të ndryshme politike që aktorë të ndryshëm në Shqipëri mund të kenë për çështje të karakterit lokal. Kur vjen puna për këtë çështje kemi demonstruar unitet dhe solidaritet", nënvizoi ministri Bushati. Duke iu referuar dialogut, ministri Bushati nënvizoi nevojën "për të vijuar në këtë proces me durim strategjik, kreativitet dhe me vendosmëri për të konsoliduar Kosovën dhe arritjen e mundimshme të saj". Nga ana e tij, ministri i Jashtëm i Kosovës, Behgjet Pacolli tha: "Kam kërkuar nga pala shqiptare të mos rrijë duarkryq dhe të shikojë çfarë po ndodh këndeje. Por pala shqiptare duhet të jetë pjesë e synimit tonë, synim kemi dialogun me Serbinë dhe ose në publik, ose pas kurrizit, të jenë aty. Nëse mundet Bashkimi Europian dhe SHBA të jenë aty pse të mos jetë edhe Shqipëria? Shqipëria mund të japë një kontribut jashtëzakonisht të madh". Ndërsa në takimin me zëvendëskryeministrin Fatmir Limaj, u diskutua mbi axhendën e mbledhjes së ardhshme të dy qeverive në Pejë në funksion të konkretizimit të marrëveshjeve sidomos në fushën ekonomike. Gjatë qëndrimit në Kosovë ministri Bushati, zhvilloi takime edhe me krerët e partive politike parlamentare.


Meta takon kryebashkiakun e Napolit: Miqësi ndër shekuj, që nga koha e Skënderbeut

Presidenti Meta ishte dje, për një vizitë në Napoli të Italisë, ku u prit në mënyrë të ngrohtë nga kryetari i Bashkisë, Luigi de Magistris. Gjatë takimit të përzemërt që pati në ambientet e Bashkisë së Napolit, Presidenti Meta theksoi domosdoshmërinë e forcimit të marrëdhënieve mes Napolit dhe Shqipërisë, veçanërisht në fushën ekonomike, turizmit dhe të kulturës. Presidenti Meta nënvizoi, gjithashtu, lidhjet e forta të miqësisë në shekuj me Napolit dhe popullit shqiptar, një miqësi që, siç u shpreh, daton që nga koha e heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Presidenti Meta e ftoi kryetarin e Bashkisë së Napolit, Luigi de Magistris të zhvillojë një vizitë në Shqipëri, ftesë e cila u mirëprit.

BEHGJET PACOLLI

"Kemi biseduar për integrimet rajonale, iniciativa të ndryshme europiane të Kosovës dhe kemi ardhur në përfundim se ndihma, mbështetja e Shqipërisë është jashtëzakonisht e nevojshme... Mos e harroni Kosovën. Kosova ka nevojë për eksperiencën dhe ndihmën e Shqipërisë. Ky vit është vit i sfidave, kemi liberalizimin e vizave, Interpolin", u shpreh zv. kryeministri kosovar.

mbi bashkëpunimin mes dy vendeve tona, por dhe rolin e parlamentit në zhvillimet e vendit. Gjatë takimit me kryeministrin Haradinaj, biseda u fokusua kryesisht në thellimin e marrëdhënieve dypalëshe, bashkëpunimin rajonal dhe atë shumëpalësh, zhvillimet në rajon dhe dialogu Kosovë-Serbi. Ministri Bushati nënvizoi mbështetjen e padiskutuar dhe të qëndrueshme të Shqipërisë për Kosovën. "Deviza jonë është



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

GJYKATA KUSHTETUESE KOLEGJII I POSAÇËM I APELIMIT

SHPALLJE VENDI VAKANT

Kolegji i Posaçëm i Apelitit pranë Gjykatës Kushtetuese (KPA), bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr.92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organike dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit":

I - Shpall vendin vakant për pozicionin "Specialist Sekretarie Gjyqësore"

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, në Drejtësi.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidati duhet të sigurohet se plotëson kriteret për të pajisur me Çertifikatë Sigurie, sipas Vendimit të Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidati duhet të ketë aftësi për të përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 11 Shtator deri më 20 Shtator në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 20 Shtator 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 11 Shtator deri më 20 Shtator 2018 në adresën: info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 (një) kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumentave (diplomë, letënjohje (ID), librezë pune) original ose të noterizuara. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njëhësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr. 3, Tiranë, www.kpa.al, e-mail: info@kpa.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BANKA E SHQIPËRISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje dhe instalim I sistemeve të vezhgimit për nevojat e degeve të Bankes së Shqiperise"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 126,000,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Ilogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përfshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje dhe instalim I sistemeve të vezhgimit për nevojat e degeve të Bankes së Shqiperise"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **09 Tetor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Vajzat rrëmbeheshin në Shqipëri, Moldavi, Rumani, Hungari

Shkatërrohet banda e prostitucionit në Itali, arrestohen 21 shqiptarë

ITALI - Policia italiane ka shkatërruar një grup kriminal, cili merrej me trafik prostitucionit. Në kuadër të këtij operacioni kanë përfunduar në pranga 21 shqiptarë dhe një grua rumune, ndërkohë që nuk dihet ende identiteti i tyre. Mediat italiane raportojnë se grupi kriminal akuzohet për "Shfrytëzim të rëndë prostitucionit". Aksioni për arrestimin e kësaj bande u realizua nga policia e Milanos, ndërsa kontrolle u ushtruan në të gjithë Lombardinë. Mësohet se grupi në fjalë shfrytëzonte vajzat për prostitucion në zonat Brianza

FITIMET

Ky grup kriminal fitonte duke dhënë me qira edhe vendet e punës në rrugë të vajzave që punonin si prostituta. Fitimi për secilin prej anëtarëve të bandës mund të arrihte edhe në 900 euro në natë. Gjatë hetimeve të operacionit të shkatërrimit të këtij grupi u sekuestruan dhe 38 kg marijuanë fshehur në një kamion në Brianza, një pistoletë dhe 25 mijë euro.

dhe Komos. Bëhet me dije se grupi është zbuluar pas vrasjes me një plumb në

zemër të shqiptarit Ilir Berisha, në 15 shtator të vitit 2017 e arrestimin në kufirin italian

me Francën të autorit të këtij krimi, shqiptarit Emiliano Bigmeti, 34 vjeç. Hetimet e mëtejshme zbuluan se vrasja ka lidhje me shfrytëzimin e vajzave për prostitucion. 25 vajzat që shfrytëzoheshin për prostitucion nga grupi i shkatërruar nga policia rrëmbeheshin në vendet e tyre të origjinës si në Shqipëri, Moldavi, Rumani, Hungari. Janë të moshës 20-25 vjeçe, por mes



tyre ka edhe një vajzë minorene. Sipas hetuesve italianë, çdo anëtar i tij zotëronte një zonë të caktuar dhe një vajzë, duke nxjerrë fitime që shkonin nga 6-12 mijë euro në muaj. Ky grup kriminal fitonte duke dhënë me qira dhe vendet e punës në rrugë të vajzave që punonin si prostitu-

ta. Fitimi për secilin prej anëtarëve të bandës mund të arrihte edhe në 900 euro në natë. Gjatë hetimeve të operacionit të shkatërrimit të këtij grupi u sekuestruan dhe 38 kg marijuanë e fshehur në një kamion në Brianza, një pistoletë dhe 25 mijë euro.

Transportoi makinat me trajler, vendimi për ndryshimin e masës së sigurisë pritet të martën

TIRANE

Klevi Lika, një prej prësorëve të arrestuar për 3.4 milionë eurot e sekuestruara në dy mjete "Toyota Yaris" në portin e Durrësit në qershor të këtij viti kërkon lirinë. Kërkesa për ndryshimin e masës është bërë nga avokati i tij, Saimir Visha, me arsyetimin se dëshiron të vazhdojë shkollën, pasi pritet të nisë vitin e dytë të gjimnazit. Në lidhje me këtë kërkesë, gjykata pritet të japë vendimin të martën e ardhshme. Ndërsa janë ende në kërkim kushërinjët Afrim dhe Elvis Vladi, të cilët sipas policisë janë porositës së ngarkesës me sasinë rekord të eurove.

OPERACIONI

Policia e Shtetit është vënë në dijeni nga burimet e saj vendëse, në datën 20 qershor 2018, ditën e mërkurë, për një karrotrac me targa AA 120 SP, që pritet të transportonte disa autovetura, mes tyre një mjet me sasi eurosh të padeklaruar, pa specifikuar tipin e automjeteve dhe as origjinën e vendit. Me marrjen e këtij informacioni, iu është dhënë porosi të gjitha strukturave të Pikat e Kalimit Kufitar për konstatimin dhe kontrollin e kësaj ngarkese. Ditën e enjte, në 21 qershor 2018, në mesditë, gjatë punimeve të Parlamentit në sallën e Kuvendit

"Toyota"-t me 3.4 mln euro, Klevi Lika kërkon lirinë

Avokati: Klienti im dëshiron të vazhdojë studimet



është bërë publik fakti lidhur me një automjet tip "Toyota Yaris" me 1.5 milionë euro, të zbuluar në Gjermani. Po atë ditë, datë 21 qershor 2018, një agjencillig zbatuese shqiptare në orën 17:00 ka njoftuar Policinë e Shtetit lidhur me një

informacion për një ngarkesë me trajler, që do të sillte disa mjete tip "Toyota", e cila pritet të vinte nga Gjermania, e mes tyre një mjet me sasi eurosh të padeklaruar. Në datë 24 qershor 2018, në Portin e Durrësit në orën 07:30, mbërriti

nga Belgjika një trajler tip "Bizar" me 9 automjete, përmes Portit të Barit. Policia Kufitare mbi bazën e porosisë së marrë në datë 20 qershor ka bërë identifikimin dhe ndalimin e mjetit. Policia e Shtetit ka njoftuar Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila po drejton hetimet. Me tej, specialistët për Hetimin e Krimeve në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin në Durrës, në bashkëpunim me efektivet e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, nën drejtimin e prokurorisë, finalizuan operacionin dhe kryen veprimet procedurale.

Policia ka arrestuar në flagrancë shtetasit Agim Çeka, 61 vjeç, lindur në Luz i Madh, banues në Durrës; Edi Lika (Cani), 41 vjeç, lindur në Dibër, banues në Tiranë;

Klevi Lika, 21 vjeç, lindur në Bulqizë, banues në Tiranë; Alban Mollaymeri, 40 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë. Gjithashtu janë shpallur në kërkim dhe punohet për kapjen e shtetasve Alfred Vladi 33 vjeç, lindur në Peshkopi e banues në Tiranë; Elvis Vladi 38 vjeç, lindur në Peshkopi e banues në Tiranë.

Gjatë kontrollit të ushtruar në Pikën e Kalimit Kufitar Durrës në automjetin tip "Bizar" të drejtuar nga shtetasi Agim Çeku dhe pronar Klevi Lika (Cani), në 2 automjete të ngarkuara në të, tip "Toyota" janë gjetur një shumë e konsiderueshme eurosh dhe franga zvicerane, të padeklaruar. Gjithashtu, janë ushtruar kontrolle në banesat dhe ambiente të tjera të personave të dyshuar. Janë

sekuestruar në cilësinë e provave materiale 3,366,800 euro dhe 100 euro që dyshohet të jenë të falsifikuar; 80,000 franga zvicerane; 10 automjete, nga të cilat 7 automjete të tipit "Toyota Yaris", 1 tip "Alfa Romeo", 1 tip "Opel" dhe 1 tip "Bizar"; 1 armë kalashnikov me 2 krehra fishkë, gjetur nga kontrolli i ushtruar në banesën e shtetasit A.Çeka; 1 radio policie; 7 telefona celularë. Nga hetimet paraprake, Policia e Shtetit ka të dhëna të besueshme se ngarkesa e sekuestruar ishte e porositur nga shtetasit Elvis Vladi dhe Alfred Vladi, tashmë të shpallur në kërkim. Hetimet po vijojnë për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe zbulimin e personave të tjerë të implikuar.

Viti i ri shkollor, drejtori i Rendit: Shtohen masat e sigurisë pranë institucioneve arsimore

Ashtu si çdo vit të ri shkollor, Policia e Shtetit ka ndërmarrë masat për rritjen e sigurisë në shkolla. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me akt të posaçëm ka urdhëruar gjitha instancat policore të studiojnë e vlerësojnë situatën kriminale dhe atë të rendit publik. Mbi këtë bazë, të hartohen plane masash me detyra konkrete për policinë. Me nisjen e vitit të ri shkollor në prani të institucioneve arsimore do të ketë prezencë të shtuar policore me qëllim vlerësimin, sqarimin në kohë, ndjekjen me përparsësi të informacioneve për parandalimin e çdo akti të mundshëm kriminal në këto ambiente. Në një deklaratë për mediat, drejtori drejtori i Rendit dhe Sigurisë

Publike në DPPSH, Albert Dervishaj tha se pranë shkollave do të ndalohej parkimi i mjeteve, do të vendosen sinjalistikat vertikale dhe horizontale si edhe do të mbylleshin lokalet dhe pikat ambulante të shpërndarë. "Nga punonjësit e policisë në bashkëpunim me drejtuesit e institucioneve arsimore dhe të pushtetit vendor janë përcaktuar masat: kufizim apo ndalim i parkimit, qëndrimi dhe lëvizjes së automjeteve në segmente rrugore të caktuara pranë shkollave. Vendosja e sinjalistikës vertikale dhe horizontale, të domosdoshme për disiplinimin e lëvizjes së automjeteve dhe këmbësorëve. Mbyllja apo largimi i lokaleve të tregtisë dhe pikave ambulante të

shpërndarë që tregtojnë pije alkoolike, produkte ushqimore të skaduar apo në ndonjë rast edhe lëndë narkotike pranë shkollave. Dhënia dhe shkëmbimi i informacioneve me stafin pedagogjik për nxënësit që mund të mbajnë me vete armë zjarri, armë të ftohta apo sende të tjera të forta të rrezikshme. Mbatja e kontakteve të vazhdueshme me rojet e shkollave dhe punonjësit e shërbimit të SHPSF-ve, në ato institucione arsimore që e kanë një shërbim të tillë. Vlerësimi i çdo informacioni që ka të bëjë me prishjen e rendit publik, konfliktet, mosmarrëveshjet që mund të kenë nxënësit apo fenomenin i bulizmit", u shpreh Dervishaj.

Kaloi vetingun, Komisioneri Publik kërkon shkarkimin e gjyqtarit Gentjan Medja

Një tjetër gjyqtar rrezikon karrierën, edhe pse u konfirmua nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Komisioneri Publik ka ankumuar vendimin ndaj anëtarit të Gjykatës Administrative, Gentjan Medja. Sipas njoftimit për shtyp të Komisionerit Publik, hetimi i KPK-së për vlerësimin e aftësisë profesionale nuk është i plotë dhe i pamjaftueshëm për të konfirmuar në detyrë gjyqtarin Medja. "Komisioneri Publik, brenda afatit ligjor ka ushtruar ankum në Kolegjin e Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese, kundër vendimit



nr.60, datë 01.08.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Medja, magistrat/gjyqtar në Gjykatën Administrative, Shkalla e Parë, Tiranë. Në

vlerësimin e Komisionerit Publik, në rastin konkret, hetimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për vlerësimin e aftësisë profesionale nuk është i plotë, duke u konsideruar i pamjaftueshëm për të konfirmuar në detyrë z. Gentjan Medja", thuhet në njoftimin për shtyp. Më herët nga Komisioneri Publik janë ankumuar edhe vendimet për prokurorin e Tiranës, Antoneta Sevdari; gjyqtarin e Tiranës, Astrit Faqolli; gjyqtaren e Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë, Alma Brati dhe gjyqtarin Edmond Islamaj.

Nipi i 77-vjeçarit: Xhaxhai u plagos me plumb në ballë, të zbardhet ngjarja

RENEA e FSNSH mësyjnë në Divjakë për kapjen e dy autorëve të masakrës së Lushnjës

Shpëtojnë për herë të 14 Laert Haxhiu e Orges Bilbili. Plagoset gjatë operacionit banori që dyshohej se i strehonte

LUSHNJE

Në orët e para të mëngjesit të djeshëm, forcat operacionale të Policisë së Shtetit, RENEA dhe FSNSH kanë zbarkuar në fshatin në Remas të Divjakës, në një operacion për kapjen e të shumëkërkuarve Laert Haxhiu dhe Orges Bilbili, të dy persona të njohur me rekorde kriminale dhe autorë të dyshuar të masakrës së 11 shtatorit të vitit që shkoi, ku mbetën të vrarë Jurgen Hoxha dhe Samir Latifi. Operacioni për kapjen e këtyre dy personave me rrezikshmëri të lartë ka dështuar, ndërsa dyshohet se është dekonspiruar. Për herë të 14-të, Laert Haxhiu dhe Orges Bilbili i shpëtojnë policisë. Ndërkaq, gjatë operacionit në fjalë ka mbetur i plagosur me plumb në kokë në rrethana ende të paqarta 77-vjeçari Haxhi Lika. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se ngjarja ka ndodhur rreth orës 05:30, kur forcat speciale kanë tentuar të hyjnë në banesën e të moshuarit, ku dyshohej se strehoheshin dy personat e kërkuar. Sipas burimeve të mësipërme, 77-vjeçari nuk i është përgjigjur thirrjes së policisë, por ka dalë me armë gjahu në dritare. Në këto kushte, efektivet qëlluan në ajër. Ndërkaq, nipi i këtij të fundit deklaroi për "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" se xhaxhai i tij u plagos në gjumë dhe se policia ka shoqëruar dy djemtë e tij, Arben e Martin Lika, përkatësisht 45 dhe 51 vjeç. Ndaj këtyre dy të fundit nuk ka ndonjë akuzë konkrete, por dyshohet se kanë lidhje me disa ngjarje kriminale në të kaluarën. Familjarët e të plagosurit bënë apel për zbardhjen e ngjarjes.

OPERACIONI

Pak ditë pas operacionit në Nikël të Krujës, Policia e Shtetit dhe forcat speciale kanë "blinduar" Rremasin e Lushnjës, me qëllim kapjen e dy personave të njohur të botës së krimit. Laert Haxhiu dhe Orges Bilbili. Pas informacioneve të siguruaruara në rrugë operative se rivalët e Aldo Bares ishin fshëhur në këtë fshat, blutë, RENEA dhe FSNSH kanë nisur kontrollin e banesave. Një prej tyre ishte dhe banesa e Haxhi Likës, i cili mbeti i plagosur me plumb në kokë. Në lidhje me plagosjen e këtij të fundit ka dy versione. Në njoftimin zyrtar të policisë thuhet: "Në zbatim të planit operacionel për kapjen e personave me rrezikshmëri të lartë shoqërore për veprën penale të vrasjes, forcat speciale RENEA, rreth orës 05:30 kanë ushtruar disa kontrollë banesash në fshatin Rremas të Lushnjës. Ndër to, edhe banesën e shtetasit H.L., 77 vjeç, pasi disponohej informacion se në këtë banesë strehoheshin dy shtetas të dyshuar si autorë vrasjesh. Në momentin që policia ka bërë rrethimin e banesës dhe konform të gjitha procedurave standarde të ndë-



Plumbat në shtëpinë e familjes Lika



Laert Haxhiu



77-vjeçari i plagosur, Haxhi Lika

Kush janë dy killerat e tmerrshëm të Lushnjës që kërkonte policia, ja krimet e kryera ndër vite

Laert Haxhiu dhe Orges Bilbili, referuar dosjeve të prokurorisë dhe gjyqësorit janë përfshirë në vrasje, plagosje, vjedhje, trafik droge etj. Ata janë autorë të dyshuar të masakrës së 11 shtatorit 2017, ku humbën jetën Jurgen Hoxha dhe Samir Latifi.

Laert Haxhiu është akuzuar dhe si autor i vrasjes së 29-vjeçarit Gerti Lala. Ngjarja ku mbeti i vrarë i riu që njihje me nofkën "Iriqi" mbeti ndodhi më 8 korrik të vitit 2010. Për këtë krim, Laert Haxhiu u dënua me 32 vjet burg, por me vendim të Gjykatës së Apelit ai u lirua pas tri viteve. Lirimi i tij u argumentua me mungesën e provave. Pasi doli nga burgu në fund të 2014-ës, ai u arrestua sërish në qershor të vitit 2015 në Durrës, për trafik

heroine, gjatë operacionit të koduar "Smart", ku u sekuestrua një sasi prej 1.2 kg heroinë. Gjatë operacionit për arrestimin e tij, Laert Haxhiu tentoi të arratisë dhe u hodh nga një mur i lartë 4 metra, ku theu këmbën. Gjykata e Durrësit e dënoi Haxhiun për mosk-

allëzim krimi, duke dhënë 17 muaj burgim për të, pavarësisht se Prokuroria e Durrësit kërkoi dënimin e tij me 8 vite burg si i përfshirë në trafik droge. Laert Haxhiu rezultoi se ishte shoku i ngushtë i Saimir Taullaut. Në vitin 2005, vëllai i Saimir Taullaut, Baki Taullau është

të ekzekutuar me armë zjarri. Familja Taullau njihet për konfliktin e hapur me bandën e Aldo Bares dhe ka akuzuar pjesëtarët e kësaj bande për vrasjen e tij në vitin 2005. Babai i Xhulios, Ramadan Shkurti, u ekzekutua në vitin 1997 nga Artur Daja dhe bashkëpunëtorët e tij. Ndërkaq, bashkëpunëtori i Haxhiut në vrasjet Lushnjë në 2017, Orges Bilbili, rezultoi se është dënuar me 7 vite e 4 muaj burgim për trafikim lëndësh narkotike. Bashkë me Haxhiun, Orges Bilbili është i dyshuar edhe për atentatin, ku u plagosën Xhulio Shkurti (nipi i Aldo Bares) dhe Sajmo Xhelili. Bashkë me dy të plagosurit ka qenë edhe Zamir Latifi, i cili asokohe nuk pësoi plagë.

armë gjahu që xhaxhai e kishte me leje.

Shoqëruan njeri?

Dy djemtë e xhaxhait tim u shoqëruan në polici. Arbeni dhe Martin Lika, 45 dhe 51 vjeç. Nuk kanë bërë asgjë, s'e di pse i shoqëruan.

Ku punojnë dy kushërinjtë tuaj?

Punojnë në një fabrikë polisteron në Kolonjë të Lushnjës, janë njerëz të ndershëm. S'kanë lidhje me krimin.

Cili është apeli juaj pas

dëmtimit dhe rrethanat". Nga ana tjetër, në lidhje me ngjarjen ka reaguar nipi i 77-vjeçarit të plagosur, Haziz Lika. "U terrorizua. Dëgjua krima armësh dhe u zgjuan nga gjumi. Na njoftuan se ishte plagosur xhaxhai në kokë", tha Hazizi. Në një intervistë për "News 24" ai tregoi momentet e tmerrit që përjetuan.

Si ndodhi ngjarja?

Në orën 4:00 të mëngjesit dëgjua krima. Dolëm me

Deputeti i PD-së, Murrizi: Shteti vret qytetarët në mes të natës

LUSHNJE - Në lidhje me ngjarjen e djeshme ka reaguar deputeti i PD-së, Myslim Murrizi, i cili ka publikuar një video në "Facebook" nga vendi ku ndodhi ngjarja, duke sjellë një tjetër dëshmi për atë ç'ka ndodhi. "Një ngjarje e rëndë ka ndodhur sot në mëngjes rreth orës 4:00 në lagjen e 'Likaj' të fshatit Rremas bashkia Divjakë. Forcat RENEA kanë terrorizuar pa asnjë shkak banorët e këtij fshati. Kanë qëlluar me armë brenda shtëpisë së z. Haxhi Lika 75 vjeç, duke e plagosur të shtrirë në krevat brenda dhomës së tij. Pastaj e kanë marrë si banditë dhe e kanë dërguar në spitalin ushtarak, pa pyetur familjarët. Ky është një shtet që vret qytetarët brenda në dhomën e gjumit, në mes të natës", shkruan Murrizi në "Facebook".

ngjarjes?

Duam të dimë se pse policia qëlloi drejt banesës së xhaxhait dhe e plagosi atë. Familja e tij s'ka bërë asnjëherë asgjë kundër ligjit. Si mund të qëllojë policia në drejtim të njerëzve të pafajshëm. Askush nuk hapi zjarr dhe askush nuk qëlloi ndaj policisë. Duam që të zbardhet ngjarja, xhaxhai im u plagos nga policia kot dhe po lufton me vdekjen.

Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, pronarët marrin 70 % të vlerës së pronës

Ornela Manjani

ATP shpërndan 313 milionë lekë, përfitojnë 155 pronarë

Lista me përfituesit në Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër dhe Elbasan

Agjencia e Trajtitimit të Pronave shpërndan 313 milionë lekë për pronarët që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. Janë në total 155 pronarë që do të përfitojnë nga fondet në dispozicion, të cilët do të kenë paratë në llogaritë e tyre brenda pak ditësh. Përfituesit janë në Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër dhe Elbasan. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë dhe të dhënat për çdo pronar që i është miratuar e drejta e kompensimit dhe pret të marrë së shpejti paratë.

NJOFTIMI

Agjencia e Trajtitimit të Pronave (ATP) njofton se, më datë 14/09/2018, ka përfunduar procesin e shqyrtimit për 155 kërkesa, të paraqitura nga subjektet përfituese, pronarë të pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekura nga ndërtimet informale, që

përfitojnë deri më tani kompensimin/shpërblimin në vlerë, në masën 70% të shumës së përgjithshme në të holla, të miratuar me Vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave. "Procesi i shqyrtimit të këtyre kërkesave dhe i shpërndarjes së fondit të kompensimit është bazuar në ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimit nga ana e ATP-së, ka rezultuar se dokumentacioni i tyre është në përputhje me kriteret e përcaktuara në

procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale", i ndryshuar dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, në të cilët është përcaktuar masa e shpërblimit për secilin pronar. Për 155 kërkesat e mësipërme, për të cilat ka përfunduar procesin e shqyrtimit nga ana e ATP-së, ka rezultuar se dokumentacioni i tyre është në përputhje me kriteret e përcaktuara në

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 383, datë 19.05.2010 "Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale", i ndryshuar"-, thuhet në njoftim. Sipas ATP-së 155 kërkesat, përfitojnë këstin e parë, të dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë të kompensimit në të holla në një total prej 70 % të vlerës totale të miratuar me VKM-të përkatëse.

FONDI

Fondi financiar që shpërndahet nga ATP për këto 155 kërkesa, është në vlerën 313 592 137,98 lekë. Të dhënat në lidhje me pasuritë që kompensohen dhe mbi gjeneratatet e subjekteve përfitues jepen në listën e mëposhtme. Agjencia e Trajtitimit të Pronave (ATP) njofton subjektet e interesuara se vlerat përkatëse për secilin përfitues do të jenë disponibël në llogaritë e tyre në bankat e nivelit të dytë pas përfundimit të procedurave të transferitave bankare në ditët në vazhdim.

ISSH-TATIMET

KLSH: Mungojnë 1.8 milionë listëpagesa

Rreth 1.8 milionë listëpagesa që përcaktojnë pagat dhe kontributet që paguhen për të rezultojnë të mos jenë transferuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve tek Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Një auditim i fundit i Kontrollit të Lartë të Shtetit pranë këtij instituti ka dalë në një sërë konstatimesh, mes të cilave edhe mungesa e informacionit që duhet të sigurohet në mënyrë periodike nga Tatimet. "Konkretisht, në fund të vitit 2017 rezultojnë gjithsej 1.810.880 listëpagesa të munguara dhe nga këto: 1.703.858, ose rreth 94% janë listëpagesa të munguara të të vetpënuarëve (biznesi i vogël); 101.226, ose rreth 6% janë listëpagesa të munguara të biznesit të madh (firma private); 5.796 janë listëpagesa të munguara të subjekteve publike (buxhetorë dhe jobuxhetorë)" vlerëson KLSH. Por problematika me listëpagesat e munguara duket se është më e hershme dhe në disa raste është kthyer edhe në pengesë për llogaritjen e pensionit për persona të caktuar që kanë mungesë të dhënash. Një situatë e tillë është evidente në vitin 2014, por vetëm për muaj shtetërorë. "Konstatohet se ka mungesa në numrin e listëpagesave vetore që duhet të dërgojë DPT-ja në ISSH dhe veçanërisht këto të identifikuar për vitin 2014, ku mungojnë një sasi e konsiderueshme e tyre dhe kryesisht për muajt tetor dhe nëntor të këtij viti. Megjithatë është vënë në dijeni zyrtarisht DPT-ja dhe po merren masat që ky informacion të kalojë në ISSH, teknikisht kjo çështje vijon të jetë në proces, duke krijuar problematika në përdorimin online të kësaj baze, sa i takon kaktimit të pensioneve të personave që kanë mungesa të dhënash", vlerëson raporti i auditit i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Sipas këtij institucioni, problematika konstatohen edhe në zbatimin e marrëveshjes midis DPT dhe ISSH, lidhur me procedurën dhe rregullat për dërgimin, apo transferimin në formë elektronike të informacionit për pagesat e kontributëve sipas subjekteve dhe individëve

PERFAQËSUESI ME PROKURË OARKU				PERFAQËSUESI ME PROKURË OARKU				PERFAQËSUESI ME PROKURË OARKU			
EMER	ATESI	MBIEMER		EMER	ATESI	MBIEMER		EMER	ATESI	MBIEMER	
ISMAIL	HYSEN	XHURA	TIRANE	ABDYL	HYSEN	KARROÇI	TIRANE	GEZIM	HYSEN	GRORI	TIRANE
NAZIF	ZYLIF	LULJA	TIRANE	INDRIT	RIFAT	MEÇJA	DURRES	FATIME	BEDRI	MANSAKU	TIRANE
BLENDI	RRAP	MAZREKU	TIRANE	AGIM	RUSHIT	TONUZI	DURRES	NADA	ALI	SKIKULI	TIRANE
INGRID	KOL	TRAJANI	ELBASAN	ABDYL	HYSEN	KARROÇI	TIRANE	FATMIR	BESIM	MURTHI	TIRANE
YLLI	MUSTAFA	HARASANI	TIRANE	LILJANA	LIMAN	AGAJ	TIRANE	FATMIR	BESIM	MURTHI	TIRANE
MEREME	SHEMO	KASMI	TIRANE	ARTAN	SHEFKI	KARROÇI	TIRANE	JEMINE	MEHMET	KORÇA	TIRANE
FRANC	EDMOND	HARASANI	TIRANE	RUKJE	RASIM	DRIZA	TIRANE	FIQRETE	HIDER	MURTHI	TIRANE
DIANA	BASHKIM	SINOUMERI (LUGA)	TIRANE	KASTRIOT	FERIDUN	XHAFERI	VLORE	MERITA	PETRIT	KARAJ	ELBASAN
MITHAT	ZENEL	HIDAJ	TIRANE	RUKJE	RASIM	DRIZA	TIRANE	HYSEN	ZYHDI	SARAÇI	TIRANE
DASHAMIR	SELMAN	KONDO	TIRANE	ARTAN	SHEFKI	KARROÇI	TIRANE	JEMINE	MEHMET	KORÇA	TIRANE
ELSA	PELLUMB	GEGA	ELBASAN	NAIM	HAXHI	NDROQI	TIRANE	IBRAHIM	ALI	TOSKA	TIRANE
DIMÇE	NAUM	MARKU	TIRANE	AFERDITA	HAMID	BERLIKU	TIRANE	IBRAHIM	ALI	TOSKA	TIRANE
BAARBARA	ARBEN	METAJ	DURRES	NAIM	HAXHI	NDROQI	TIRANE	OLTION	REFIK	HASALLIU	TIRANE
KEL	NDOK	VATUKA	TIRANE	AGIM	QEREM	SEFERI	DURRES	OLTION	REFIK	HASALLIU	TIRANE
ARBEN	FEJZI	HOXHA	FIER	ISMAIL	HYSEN	XHURA	TIRANE	OLTION	REFIK	HASALLIU	TIRANE
ARBEN	SHEFOET	HOXHA	TIRANE	ISMAIL	HYSEN	XHURA	TIRANE	OLTION	REFIK	HASALLIU	TIRANE
RESHAT	DERVISH	ABAZI	TIRANE	MIRAND	AGIM	FUGU	TIRANE	OLTION	REFIK	HASALLIU	TIRANE
MIRANDA	YMER	NOË	TIRANE	HAXHI	SELMAN	ELEZI	TIRANE	OLTION	REFIK	HASALLIU	TIRANE
SHEQERE	HAXHI	ÇULLHAJ	TIRANE	EQEREM	QAZIM	TUGU	TIRANE	OLTION	REFIK	HASALLIU	TIRANE
SHERIFE	SELM	HOXHA	TIRANE	NJAZI	QAZIM	TUGU	TIRANE	OLTION	REFIK	HASALLIU	TIRANE
XHEMILE	HAXHI	KUBURI	TIRANE	MYSTEHAK	FERIDUN	XHAFERI	VLORE	OLTION	REFIK	HASALLIU	TIRANE
ENVER	MALIQ	ABAZI	TIRANE	BASHKIM	ABDYL	KARROÇI	TIRANE	SOKOL	ZENEL	KOKOSHI	VLORE
VELI	SELIM	ABAZI	TIRANE	BESNIK	FERIDUN	XHAFERI	VLORE	SOKOL	ZENEL	KOKOSHI	VLORE
MUSA	HAXHI	ABAZI	TIRANE	SAIMIR	KADRI	BIBA	TIRANE	SOKOL	ZENEL	KOKOSHI	VLORE
HARIZ	HAXHI	ABAZI	TIRANE	BASHKIM	ABDYL	KARROÇI	TIRANE	GEZIM	SEIT	ÇULLHAJ	TIRANE
OSMAN	RAMAZAN	ABAZI	TIRANE	HAZBI	SHAQIR	BLETA	DURRES	GEZIM	SEIT	ÇULLHAJ	TIRANE
HASAN	PASHA	DERJA	TIRANE	DASHMIR	ASLLAN	QELI	GJIROKASTER	ARBEN	SUBI	MASKAJ	VLORE
KUJTIM	ABDYL	BAKALLI	TIRANE	BEQIR	SHYQYRI	FUGA	TIRANE	ARBEN	SUBI	MASKAJ	VLORE
ILJAZ	MAKSUT	RAUFI	TIRANE	VELI	SHABAN	LAMI	TIRANE	ELMOZA	JUSUF	GORJA	TIRANE
HATIXHE	SELM	BALLA	TIRANE	MIRANDA	ZYBER	SHEKU	TIRANE	RAIMONDA	JUSUF	BAKALLI	TIRANE
ARBEN	SHEFOET	HOXHA	TIRANE	ANILA	KADRI	DEMIRI	DURRES	ALBINA	SEZAI	HOXHA	VLORE
MIRELA	RIFAT	MEÇJA	DURRES	SERVETE	SEID	SHIMA	TIRANE	KUJTIM	NJAZI	BARBULLUSHI	DURRES
ERVIN	FATBARDH	NEPRAVISHTA	FIER	LEDRI	GANI	KARROÇI	TIRANE	ZAMIRA	HASAN	KAJMENE	DURRES
LIRIJE	MEHMET	DEMRAJ	DURRES	ELISABETA	XHEMAL	BAJRAMI	ELBASAN	NAIM	ISMAIL	ÇELA	DURRES
BASHKIM	MEHMET	MEÇJA	DURRES	LEDRI	GANI	KARROÇI	TIRANE	MIRELA	FIQIRI	KASA	DURRES
AGRON	TEKI	TELA	DURRES	MYRIJE	YMER	PETRELA	TIRANE	ARBEN	BESIM	FAGU	TIRANE
ARTUR	TAHSIM	KOSOVA	DURRES	ISMAIL	HYSEN	XHURA	TIRANE	VASIL	JORGJI	SANTO	ELBASAN
DIMÇE	NAUM	MARKU	TIRANE	ROLAND	PELLUMB	SHARRA	VLORE	ROLAND	SULEJMANQOSJA	TIRANE	TIRANE
RAIMONDA	BESIM	MYDINLLARI	TIRANE	AJDIJE	YMER	BISHA	TIRANE	ROLAND	SULEJMANQOSJA	TIRANE	TIRANE
EDLIR	AGIM	MUMAJESI	TIRANE	HYSEN	SHYQYRI	HYSKJA	ELBASAN	ROLAND	SULEJMANQOSJA	TIRANE	TIRANE
DIMÇE	NAUM	MARKU	TIRANE	YLLI	REFIK	ÇULLHAJ	TIRANE	ROLAND	SULEJMANQOSJA	TIRANE	TIRANE
ARBEN	SHEFOET	HOXHA	TIRANE	NINFA	SKENDER	ZIU	VLORE	ROLAND	SULEJMANQOSJA	TIRANE	TIRANE
ARBEN	SHEFOET	HOXHA	TIRANE	BARDHUL	KUJTIM	YMERAJ	TIRANE	BARDHUL	FATMIR	HAXHIHYSENIE	ELBASAN
ARBEN	SHEFOET	HOXHA	TIRANE	BARDHUL	OSMAN	DEMNERI	TIRANE	BARDHUL	FATMIR	HAXHIHYSENIE	ELBASAN
DRITA	GANI	KARROÇI	TIRANE	ILIR	QERIM	ALLUSHI	TIRANE	BARDHUL	FATMIR	HAXHIHYSENIE	ELBASAN
ARIAN	GANI	KARROÇI	TIRANE	BUJAR	OSMAN	DEMNERI	TIRANE	BARDHUL	FATMIR	HAXHIHYSENIE	ELBASAN
ISLAM	QAZIM	TUGU	TIRANE	ILIR	QERIM	ALLUSHI	TIRANE	BARDHUL	FATMIR	HAXHIHYSENIE	ELBASAN
DRITA	GANI	KARROÇI	TIRANE	HIQMET	ABDYRRAHMANKADIU	TIRANE		MARIO	KRISTAQ	SHUKA	DURRES
ARIAN	GANI	KARROÇI	TIRANE	DASHAMIR	ALI	TOSKA	TIRANE	SAIMIR	KADRI	BIBA	TIRANE
SAIMIR	KADRI	BIBA	TIRANE	DASHAMIR	ALI	TOSKA	TIRANE	HILMIJE	QANI	KRYPA	ELBASAN
EDA	ISUF	MAÇI	TIRANE	DASHAMIR	ALI	TOSKA	TIRANE	ARIAN	BEDRI	ALLA	TIRANE
				DASHAMIR	ALI	TOSKA	TIRANE	ARTA	RAMADAN	KADUKU	ELBASAN


SPECIALE

Princi shqiptar "Malik"

Një "peshkatar perlash" në periferinë parisienne

Nga Luan Rama

Historia e një burri që shënjoj një zonë të kryeqytetit francez



Një Princ shqiptar në Paris? Kur dhe në ç'kohë? Vallë bëhet fjalë për Esat Pashë Toptanin që në selinë e tij "qeveritare" në Hôtel Continental, pranë Place de la Concorde të Parisit, i cili paraqitej kudo si Princ i Shqipërisë apo Alejandro Kastrioti, ky pinjoll i një prej degëzimeve të familjes Kastrioti, që si "Princ", ishte pretendent i fronit të Shqipërisë, krahas Princit De Wied në vitin 1913? I zemëruar ndaj këtij të fundit, poeti i famshëm Apollinaire kishte shkruar artikullin e njohur "Tre Princër të rremë të Shqipërisë", botuar në gazetën L'Européen... Jo, është fjala thjesht për një emigrant shqiptar, që s'kishte asgjë mbretërore në gjakun e tij, i cili në fillimet e shekullit XX kishte zbarkuar në Paris, pikërisht atëherë kur Evropa mendonte për një Princ të huaj për Shqipërinë.

Ka një treg të madh vjetërsirash në Paris, i cili gjendet në periferi të qytetit, në Porte de Saint-Ouen. Thuhet treg vjetërsirash meqë janë gjëra të përdorura, por, në fakt, është një botë objektesh nga më të habitshme dhe shpesh me shumë vlera, ku gëlojnë antikuarët e gjithë botës, deri nga Amerika, të cilët vijnë të gjejnë objekte që u përkasin epokave të kaluara. Mjafton të hysh në labirintet e tij për t'u gjendur pas pak midis uniformash të vjetra ushtarake të ushtrisë mbretërore apo napoleoniane, midis mobilieve të stilit Louis XIV apo Louis XV, tablo të vjetra, afishe, kartpostale të shekullit XIX, maska afrikane, etj. Ja pse para disa vitesh regjisor i njohur Woody Allen erdhi këtu të xhironte një skenë filmi, i tërhequr në mënyrë të veçantë për rrugicat dredharake e frakturat e këtij tregu gjigand, ku çdo ditë vizitohet nga 120.000 njerëz. Tregu MALIK gjendet pikërisht këtu, përkrah tregut "Biron" apo "Ver-naison", por të gjithë së bashku përbëjnë një ansambël tepër tërheqës, që rrallë e gjen në një vend tjetër të botës. Sidoqoftë, sapa zbrit nga metroja dhe shkon drejt këtij pazari gjigand, të bije në sy

tabela ku shkruhet MALIK. Kisha shkuar disa herë në këtë vend të zhurmshëm, ku gëlojnë dhjetëra mijëra njerëz në kërkim të objekteve të rralla. Janë të kombësive të ndryshme: francezë, italianë,

ak me njerëz të kombësive të ndryshme, të cilët, pas luftës, kishin të drejtë të merrnin kombësinë franceze, meqë kishin luftuar për Francën.

"PESHKATARËT E HËNAVE"



afrikanë, ballkanikë, aziatikë. Kohët e fundit, aty është vendosur dhe një shqiptar që ka hapur një dyqan mobilie antikë. Dhe kjo gjë atë e pasionon. Por gjithnjë ai emër, MALIK më kishte intriguar. Vallë një emër shqiptar?... Dhe kështu, duke u interesuar, zbulova më së fundi se krijuesi i parë i këtij pazari të madh të "Porte de Saint-Ouen" kishte qenë shqiptari Maliq Hajrullahu, një shqiptar që kishte ardhur gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore, ashtu siç kishin ardhur dhe disa shqiptarë të tjerë nga bregu i jugut shqiptar apo nga Përmeti, Leskoviku, etj., të cilët ishin futur në "La Legion Etrangère", një formacion ushtar-

një treg të hapur objektesh të vjetra, duke ngritur dy shtylla hekuri me xhama të mëdha. Në fakt, që prej shumë kohe këto tregje ishin hapur në Paris dhe së pari, në vitin 1350 në sheshin e kishës Saint-Médard, nga vetë peshkopit i kishës. Por ato lulëzuan më shumë në shekullin e XIX. Çuditërisht, për disa dhjetëvjeçarë ato u zhdukën deri sa të shfaqej ky shqiptar. Ata që shisnin atje quheshin në atë kohë "chiffonniers" ("leackaxhinj") apo "pecheurs de lune", ("peshkatarë hënash") dhe vendet ku shiteshin objektet quheshin "cours des miracles", (oborret e mrekullive"), etj.

Pra, Maliq Hajrullahu, ky shqiptar i zgjuar mori një nismë të guximshme: rihapjen e tregjeve të vjetërsirave, të quajtur "Marchés aux Puces", (apo në frëngjisht "Tregjet e Pleshtave"). Kështu pas

Sarte e Normandisë dhe kishte një djalë, - më thoshte një ditë vajza e një emigranti shqiptar, Alice Shushi. Madje ajo mbante mend se një ditë ai i kishte sjellë tek i ati në restorant, një kukull të bukur... Ai mbahej si një zotëri i madh, me kostum e kravatë, prandaj dhe nisën ta thërrasin "Princi Malik". Ajo e kishte njohur "princin" Malik që kur ishte adoleshente. "Vërtet, qëndronte si fisnik, me shtatin e tij të lartë dhe lëvizjet e tij hijerënda. Ishte mik i babait. Por megjithatë ishte një njeri i qeshur. Vinte shpesh në restorant, madje dhe kur mblidheshin shqiptarët në darkat e zhurmshme dhe plot këngë të "Ditës së Flamurit" në 28 nëntor. - "Po më vonë, ç'u bë me të?", e pyeta unë me kuriozitetin për të ditur më shumë rreth këtij personazhi të jashtëzakonshëm sikur të kishte dalë nga bota



Kur Maliq Hajrullahu kishte zbarkuar në Paris, pas një eksperiencë të vështirë në kryeqytetin francez, ai arriti të blejë restorantin e një italiani, "A Piccolo", dhe më pas bleu një terren prej 3000m² që shkente nga cepi i Parisit në rrugën "Jules Valles" të Saint-Ouen dhe pikërisht aty, ai krijoi

këtij shqiptari apo në të njëjtën kohë me të, (1919-1920), ishte dhe Romain Vernaison dhe Paul Bert që erdhën të hapin tregjet e tyre. Në vitet 30-50', Maliq Hajrullahu njihje në mjedisin francez si "Princi Malik", meqë gërma "Q", shqiptohej në "K". "Malik u martua me pas me një franceze nga Mesle-sur-

e përrallave. "Nuk di gjë për vitet e fundit të tij. Di që kishte një familje dhe banonte në Paris. Por sigurisht, ai ka vdekur si gjithë gjenerata e tim ati", - shtoi ajo duke vazhduar bisedën rreth mbrëmjeve simpatike në atë restorant ku jo rrallë shërbente dhe ajo bashkë me të ëmën e më pas me njerëkën e saj.

TEATRI METROPOL

Teatri Metropol vazhdon traditën me premierat e tij. Se zoni i dytë artistik shtator-dhjetor sjell larmi veprash, shqiptare të shpluhurosura nga arkivi, e vepra të njohura në mbarë botën, duke përfshirë në këto projekte aktorë karriere apo aktorë të rinj, regjisorë me eksperiencë apo regjisorë me potencial të ri artistik. Teatri Metropol duke synuar të ndjekë ritmet e zhvillueshmërisë së qytetit, në ditët e para të muajit tetor do të nisë edicionin e dytë të festivalit të dramës shqipe "Metrofest", që pas vitit të kaluar, kësaj here shtrihet në dy javë aktivitet. "Ashtu si në edicionin e parë, edhe sivjet Teatri Metropol, i dedikohet njohjes dhe vënies në skenë të dramaturgjisë shqiptare. Qëllimisht ky festival nuk ka natyrë konkurruese, por e vë theksin tek laboratorit e punës me veprën shqiptare. Të pesë premierat e këtij edicioni janë produksione ekskluzive të Metropolit, duke afruar profesionistë të teatrit nga të gjitha brezat për të hulumtuar dhe për t'i dhënë frymë dramës shqipe në skenë, afër publikut", shprehet drejtoresha e Teatrit Metropol, Jonida Beqo. Ky edicion i "MetroFest" sjell pesë vepra shqiptare të nxjerra nga arkivi, si "Rrajtë që lëvizin" e autorit Ernest Koliqi, "E bija e krahinarit" nga Kristo Floqi, "Kryet e hudhrës" nga autori Kristë Berisha, "Makarona e shejtanit" nga Lazër Lumezi si dhe "Prangat" nga autori Halil Laze etj. Gjithashtu, netët e këtij festivali do të ndërthuren dhe me aktivitetet e tjera alternative. Sezoni i ri në Metropol do të vijojë më tej gjatë muajit nëntor me "Ditari i Ana Frank" i autorëve Frances Goodrich dhe Albert Hackett dhe "Sherlock Holmes dhe qentë e Baskervillit" e autorit Ken Ludwig veprë që do të vihet në skenë në fund të vitit. Aktualisht për këto dy vepra Teatri Metropol ka shpallur audicione për aktor/aktore që do të interpretojnë në këto dy vepra, teatër, i cili ka thyer "mitin" e realizimit të audicioneve në institucionet artistike shqiptare.

SHFAQJET PËR TË RINJ E FËMIJË

"Teatri Metropol ka një prioritet të veçantë zhvillimin e teatrit për fëmijë dhe të rinj, jo si një zhanër inferior ndaj teatrit të të rriturve, por me të njëjtin angazhim profesional dhe dedikim. Shfaqjet tona përzgjidhen duke pasur synime të qarta edukative, duke respektuar inteligjencën dhe psikologjinë e publikut të të vegjëlve", shpjegon Beqo. Sezoni nis me shfaqjen për fëmijë "Miushet e shkathëta", "Njëlljoji si ti", "Atje ku hëna takon malin" e më tej me veprat për të rinj "Romeo e Zhuljeta" e William Shekspir dhe "Ditari i Ana Frank" në versionin për të rinj. Specialistët e Metropol japin orë teatër në dy nga shkollat e zonës "Lidhja e Prizrenit" dhe "Hasan Vogli" e më pas klasat e pesta dhe të gjashta gjatë 9 muajve shpirtit dhe shfaqjet, luajnë rolin e kritikut dhe bëjnë prezantimin e punëve të tyre në fund. Misioni i Qendrës Kulturorë Tirana është të pasurojë, edukojë dhe argëtojë në mënyrë gjithëpërfshirëse publikun në mbarë territorin e Tiranës, me anë të eksperiencave artistike, të cilat promovojnë vlerat me të mira kombëtare dhe botërore. Teatri Metropol në kuadër të platformës edukative këtë vit organizoi kampet verore,



Një sezon nga Ana Frank te Kristo Floqi

13 mijë spektatorë në vitin 2018 dhe synimet me shtresat në vështirësi



dy grupe paralele me nga 25 fëmijë, ku këtë vit mbante titullin "Kujtime nga Ilira e lashtë" proces i bazuar në fushat: histori dhe arkeologji. Gjithashtu, për herë të parë në Teatrin Metropol u organizua kampi i dytë veror i përbërë nga

një grup nxënësish të shkollës së mesme "Ismail Qemali" mbi temën: "Të mësojmë rreth traditave dhe zakonëve të cilat janë pjesë përbërëse e qytetërimit tonë", një studim mbi këngët dhe vallet shqiptare. Për herë të parë u zhvillua Festivali Ndërkombëtar i Kukullave, "International Puppet Theatre Festival Albania". "Skanderbeg" organizuar nga Klau's Film Association dhe Teatri Metropol. Përgjatë një jave morën pjesë trupat të ndryshme nga Kina, Turqia, Spanja, Rumania dhe Shqipëria, të cilat performuan për të prezantuar forma të ndryshme përdorimi dhe komunikimi nëpërmjet kukullave, shkëm-

bulim eksperiencash, traditash dhe kulturash të vendëve të ndryshme dhe u ndoqën nga 2210 spektatorë, numër ky vetëm në ambientet e brendshme të teatrit. Shfaqjet u dhanë edhe në sheshin "Skënderbej", ku pjesëmarrja e spektatorëve ishte e larmishme dhe e madhe në numër.

SHIFRA DHE PËRPARËSI

Gjashtë mujorin e parë të këtij viti, Teatri Metropol thotë se ka pasur një rritje të ndjeshme në numrin e spektatorëve me rreth 13 mijë spektatorë (flasim këtu vetëm për shfaqjet teatrore për të rritur, fëmijë, e të rinj, nuk përfshihen në këtë shifër festivali ndërkombëtar për fëmijë, kampet

verore). Ndërkohë Ansambli Tirana në koncertet dhe aktivitetet e tij jashtë ambienteve të teatrit ka arritur shifrën 5500 spektator, përgjatë gjysmës së parë të vitit. "Ansambli Tirana punon me qëllimin e njohjes së traditës kulturorë kombëtare, lëvrimin dhe shpalosjen e saj nëpërmjet koncerteve për publikun, por edhe nëpërmjet programeve tona edukative që sjellin këngën, vallen dhe kostumin kombëtar pranë publikut", thotë ajo. Por pjesë e përhershme e produksioneve të Teatrit Metropol janë edhe përfshirja e spektatorëve shtresa të ndryshme vulnerabël nga Instituti i Fëmijëve që nuk shohin "Ramazan Kabashi", nga Qendra ditore "Të qëndrojmë së bashku", Shtëpia e Fëmijës "Zyber Hallulli", "Burgu i grave si dhe "Fëmijët e të burgosurve", "Shoqata e fëmijëve jetim", "Kryqi i kuq" etj. Ky publik përfiton pjesëmarrje falas në të gjitha aktivitetet e Qendrës Kulturorë Tirana si shfaqje për të rritur, teatri për të rinj dhe teatri për fëmijë, si dhe të aktiviteteve të Bandës së qytetit dhe Ansambli Tirana. Sezoni e parë janar-korrik është shënuar numri 2790 fëmijë nga shtesa në nevojë dhe afërsisht 800 persona nga "Qendra Ditore Multifunkionale e të mosharve", Gratë e Burgosura apo Azili i Pëleve.

"100 FUSTANET"

Pavarësisht se është teatri i kryeqytetit, Teatri Metropol e shtriu aktivitetin e tij edhe jashtë kufijve të Tiranës. Përveç rrethit të kryeqytetit ku shfaqjet e këtij teatri kanë qenë prezentë, gjatë muajit maj- qershor shfaqja për të rinj "100 Fustanet" e autorës Eleonor Ester me regi nga Jonida Beqo ka përkrahur qytetin të ndryshme të Shqipërisë, sa më pranë fëmijëve në nevojë; kryesisht në Librazhd, Laç, Dibër, Durrës, Mamurras, Korçë, Elbasan e Lezhë, në bashkëpunim me "Worldvision Albania". Ky tur është ndjekur nga rreth 2500 fëmijë.

IHRFFA

FESTIVALI I FILMIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT, PËR KËRCËNIMIN E SË VËRTETËS

Nga e hëna e 17 shtatorit deri më 22 shtator 2017 do të zhvillohet edicioni i Trembëdhjetë i Festivalit Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri - IHRFFA (www.ihrffa.net) tashmë një ngjarje me rëndësi jo vetëm për Tiranën, por edhe një nga eventet më të rëndësishme kinematografike që zhvillohen në Shqipëri. Nëse vitet e kaluara Festivali ishte i fokusuar tek krimi i organizuar dhe korrupsioni, terrorizmi apo migracioni, këtë vit aktiviteti vjen me një tematikë të mprehtë që në fokus do të ketë: Kërcënimi i së vërtetës. Në edicionin e 13-të IHRFFA, nga 3400 aplikime janë përzgjedhur 43 produksione. Hapja e Festivalit zhvillohet të hënën, ora 19.00 me ceremoninë hapëse dhe shfaqjen filmit të parë "Iuventa" produksion gjerman të regjisorit italian Michele Cinque, në prani të regjisorit. Të ftuar janë aktori nga Greqia Athanasios Chalkias për filmin LINES, Hank Levine nga Gjermania regjisorit i filmit "Exodus", Orgesa Arifi me filmin "Kurrizi" nga Kosova, i ftuar special Andrew Feinstein gazetari dhe shkrimtari për filmin Shadow World, Askold Kurov regjisor rus për filmin THE TRIAL - the state of Russia Vs Oleg Sentsov, për regjisorin ukrainas, i cili është në burg në Siberi. Përveç Akademisë së Filmit dhe Multimedias Marubi, si dhe Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit, filmat do të shfaqen edhe në Europe House (te Pallati i Kongreseve), në Akademinë e Sigurisë, në Destil, instalacionin REJA pranë Galerisë Kombëtare të Arteve dhe COD. Së pari, Forumi në Europe House mbi "Portalet, porta hyrëse dhe/apo dalje të vërtetës?", ditën e martë 18.09.2018, pas shfaqjes në orën 11.00 të dokumentarit "News 23/06/2016".

Ditën e mërkurë, 19.09.2018, ora 11.00 më tej shfaqje speciale me studentët të akademisë së sigurisë dhe persona të dënuar me dënime penale në Akademinë e Sigurisë, me filmin "Pre-Crime" të regjisorit gjerman Monika Hielscher, Matthias Heeder, dhe më pas

do të marrin pjesë në forumin për "Tëknologjia dhe parandalimi i krimit";

Gjithashtu, të mërkurën, 19.09.2018 ora 21.00, në Destil në bashkëpunim me Universitetin POLIS shfaqet dokumentari "Blue Heart", i cili dokumenton betejën për Vjosën, në Shqipëri, lumi më i madh pa digë në Europë, dhe situata të ngjashme në Ballkan, dhe më pas vijohet me diskutimin me temë "Krimet mjedisore: sa dimë për to?"

Duke qenë se për drejtuesit e Festivalit mbetet prioriteti fokusi-mi dhe përfshirja gjithnjë e më e madhe e të rinjve, në subjektet që trajtojnë filmat, është menduar që ditën e enjte 20.09.2018, ora 11.00, në sallën e kinemasë Marubi në bashkëpunim me gjimnazin "Sami Frashëri" të shfaqet filmi "Find Fix Finish" dhe të vijohet me një debat me nxënësit me temë: "Realiteti fizik dhe virtual". Ditën e premtë me 21 shtator ora 11.00, në Europe House shfaqet filmi i shkurter "Dysphoria" i Gjergj Bodani dhe vijohet me debatin moderuar nga shoqatën OMSA, Open Mind Spectrum Albania. Bordi i festivalit IHRFFA uron dhe shpreson që filmat e përzgjedhur këtë vit do të përcjellin rëndësinë e këtyre çështjeve dhe do të nxisin diskutime dhe debate edhe më tej gjera për publikun shqiptar. Gjithashtu, do të ketë mbremje muzikore

re të hënën për hapjen, me Bandën Muzikore "Orge(s) Trio", të martën me EDA CËRRRIKU & ELTON BALLA, të mërkurën me AJS TRIO, të premtën me ALBANIAN BRASS QUINTET, dhe në mbyllje me HERIN & ECLESIO RAMOS. Bordi i IHRFFA-s falënderon për bashkëpunimin dhe mbështetjen e madhe të gjithë partnerët e angazhuar, veçanërisht ambasadën gjermane, delegacionin e Bashkimit Europian, Bashkinë e Tiranës, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Arsimit, Arkivin Qendror të Filmit, ambasaden austriake, OSBE, etj.

LISTA E PLOTË/ Ja kur duhet të paraqiteni pranë KMCAP

KEMP-i, zbardhen emrat e 308 personave që do të kryejnë kontrollet mjekësore

Voltiza Duro

(vijon nga nr. 1 kaluar)

Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka zbardhur emrat e personave që do të nënshtrohen kontrolleve mjekësore në KMCAP Epror gjatë muajit shtator për të marrë pensionin. "Gazeta Shqiptare" publikon sot listën e plotë me emrat e 308 personave që duhet të kryejnë ekzaminimet brenda muajit pranë Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë. Këta individë, në rastin që nuk do t'i nënshtrohen kontrollit mjekësor, nuk do të mund të marrin apo rimarrin pensionin e invaliditetit nga ISSH. Të gjithë ata persona që bëhen të paafte për çdo veprimtari ekonomike dhe kanë dëmtime fizike apo gjytime të forta, duke përfshirë verbimin, iu lind e drejta për pension invaliditeti. Për të përfutur këtë lloj pensioni të plotë, të reduktuar dhe të pjesshëm, përfutuesi ose i autorizuari me prokurë vendoset në ALSSH të vendbanimit, sipas regjistrimit në gjendje civile, për të bërë kërkesën e përfutimit të pensionit të invaliditetit. Përfutuesi për pension invaliditeti ose i autorizuari me prokurë, së bashku me kërkesën duhet të paraqesë dhe dokumentet që vër-tetojnë moshën dhe identitetin, ato që vër-tetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës si dhe dokumentet që vër-tetojnë të ardhurat e realizuara e gjendjen shëndetësore. Ky dokumentacion i dorëzohet mjekut të ekspertizës, i cili pas verifikimit, njofton datën për të kaluar në KMCAP, ose i kthen mbrapsht dokumentet për pasaktësi. KMCAP në mbledhjen e tij shqyrton paraprakisht dokumentet, njofton dhe ekzaminon të sëmurin, merr vendimin përkatës jo në prani të tij dhe kryetari i KMCAP-it ia komunikon zyrtarisht të sëmurit gojarisht dhe nëpërmjet vër-timit-tip. Kundër këtij vendimi, i sëmuri ose invalidi mund të ankoher tek KMCAP-i epror. Ankesa bëhet me shkrim dhe dorëzohet në DRSSH përkatëse.

Table with 7 columns: ID, Name, Last Name, Specialization, Date, Time, Location. Includes sections for ORTOPEDI, KIRURGI, PATHOLOGJI, and PSIKIAT/OCULIST.



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 627


SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela Aliaj - Art Designer: Nevila Samarxhi
E shtune 15 Shtator 2018

MODELJA

IVA ALIKO



ISH-E DASHURA E DEPUTETIT
NGA KOSOVA PUBLIKON FOTO NUDO



FANSI
KERKON TA 'RREMBEJE',
EINXHEL SHKIRA: JE VONE

ERIONI & AJOLA

NE PRITJE TE NJE DJALI!

EKSKLUZIVE

*Prindër për herë
të parë, fotot e
9 muajve të shtatzënisë*



5
Dance With Me

ALKETA VEJSIU:

Do të ketë evolucion. Të papriturat e këtij edicioni
"Këtë vit kemi një kastë shumë të freskët dhe interesante"

Rrëfëhet moderatorja: Ja surprizat e natës së parë

Nis të hënën "Dance with me 5",

ALKETA VEJSIU:

Do të ketë evolucion!

Të papriturat e këtij edicioni

Pas një vere të nxehtë shtatori është muaji i mobilizimit për të gjithë. Kjo përfshin edhe vip-at tanë, të cilët në një mënyrë apo në një tjetër arritën të largohen nga stresi dhe puna e përditshme për pak apo shumë kohë. Ky muaj kaq i vrullshëm do të sjellë risi dhe rinisje të shumë programeve në ekranet shqiptare. Një ndër to është edhe "Dance with me 5", e cila do të fillojë këtë të hënë në tv Klan. Por cilat do të jenë risitë e radhës e çfarë të papriturash e surprizash na rezervon ky edicion? Në një prononcim për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", Alketa Vejsiu, imazhi, tashmë prej vitesh i këtij formati dhe jo vetëm, ka zbuluar disa detaje të pathëna më parë. Risi, ndryshime dhe për më tepër... çmimi dhe jo vetëm, janë ato që ky produksion do të sjellë këtë herë. Për më tepër në intervistën e mëposhtme:



"Këtë vit kemi një kastë shumë të freskët dhe interesante"

Pamela Aliaj

Çfarë do të ketë ndryshe nga sezonet e tjera?


Ndryshe janë shumë gjëra. Duke filluar që nga skena, anëtarit i jurisë që do të jetë balerini Kledi Kadiu si dhe çmimi financiar që do të jepet në fund të çdo episodi.

Cila është surpriza e natës së parë?

Surpriza e natës së parë është vetë nata e parë. Çdo vit ka një evolucion seriali.

Me çfarë zhanri të kërcimit do të hapet nata e parë?





Nuk mund të them një zhanër të veçantë, sepse do të jetë mix, do të përfshihen të gjitha zhanret.

Keni propozuar ndonjë Vip që s'ka pasur mundësi apo për çfarëdo arsye nuk është bërë pjesë e show-t?

Po tratativat me vipat janë gjithmonë të vështira. Njerëzit e artit dhe tv në Shqipëri janë të gjithë të zënë dhe të ngarkuar me punë dhe axhenda. Ndaj fillimisht kontaktimin e tyre që shumë kohë më parë. Them që këtë vit kemi një kastë shumë të freskët dhe interesante.

Çifti i aktorëve Eni Jani me Genc Fugen do të jenë? Vura re që s'janë postuar në foton e "Dance with me" edhe pse janë pjesë e spotit?


Patjetër që po.

Ndërkaq nuk ka 'shpëtuar' pa u pyetur edhe konkurrenti, i cili qëndron më larg gjeografikisht nga të tjerët në këtë konkurs. Siç e kemi parë dhe vitet e tjera, konkurrentët

fansat mëngjesin e ditës së djeshme. Teksa udhëtonte drejt Tiranës për puntatën e parë që nis të hënën në TV Klan, 40-vjeçari ka deklaruar se ai nuk do të jetë i pranishëm aq sa duhet në provat që artistët bëjnë gjatë javës për spektaklin, por vetëm 3 ditë në javë. "Kam gjëra më të rëndësishme siç është muzika, sepse normal ajo është puna ime", -tha artisti në 'Instagram'. Gjithashtu, ai shtoi se nuk ka ardhur në spektakël për të fituar çmimin e parë, por thjesht dhe vetëm për ta provuar si eksperiencë. Tani na mbetet të shohim si do të paraqitet bashkëshorti i Nora Istrefit në garë e vallëzimit, një spektakël ku ka marr pjesë më herët edhe vet këngëtarja. Këngëtarja do të jetë çift këtë vit me misin shqiptar, Leji Kraja. Të shohim kush do të jetë fituesi!

nga Kosova, dhe jo vetëm, kanë qenë ata që kanë pasur mungesa në paraqitjen e tyre 100% në prova të show-t. Këtë vit, ai që do t'i bëjë 'bisht' deri diku do të jetë pikërisht këngëtarja Robert Berisha, bashkëshorti i këngëtares Nora Istrefi. Robert Berisha, që është pjesë e kastit të personazheve të njohur në këtë edicion të spektaklit "Dance with me" ka folur për këtë eksperiencë në një video live të bërë me

MARINA FARA shtatzënë? Eli i publikon foton ku tregon të vërtetën



marinafara.new.official

Vetëm 3 muaj më parë në rrjetet sociale ka qarkulluar lajmi se Marina Fara, është në pritje të ëmbël. Ndërkohë që nuk bë asnjë postim për të kundërshtuar, Eli Fara ka ndarë një foto mjaft befasuese të së bijës. Marina ka pozuar në shtëpinë e gjyshërve, por mban veshur një bluzë që i nxjerr barkun jashtë. I rrafshtë dhe i palestruar, dhe pa pikë lidhje me shtatzëninë. Por sërisht dyshimet ekzistojnë, se fotot edhe modifikohen, por ndoshta nuk është dhe aktuale. Por ajo që bën akoma më tepër përshtypje është fakti se Marina ka mbyllur llogarinë e saj të vjetër në 'Instagram' duke hapur një të ri. Mund të mendohet se shtatzënia e saj ka ndikuar një vendim të tillë, por ende nuk mund ta themi me siguri.



Habisin me vendimin e papritur, fejohet çifti i njohur shqiptar

Ata janë ndër çiftet më të ëmbla të showbizit. Nga postimet e tyre ata preferojnë të qëndrojnë jashtë kuintave të medias rozë dhe kjo mbase ka nxitur edhe në vendimin e tyre. Vetëm para pak ditësh ata kanë vendosur që, në një ceremoni sekrete të kurorëzojnë dashurinë e tyre me fejesë. Dyshja Venera Lumani dhe Lind Islami janë fejuar që në qershor të këtij viti, ndërsa tani kanë bërë edhe festën. Ata e kanë zbuluar fejesën me anë të rrjetit social 'Instagram', kurse ka qenë Olti Curri ai i cili ka treguar se ata kanë pasur edhe një ceremoni për të festuar këtë moment të veçantë, ndërsa festën e kanë bërë në Tiranë. Urime Lindi dhe Venera! Me siguri dhe dasma do të jetë aq e fshehtë sa dhe fejesa.



Më në fund e vërtetuar! Keisi dhe Stresi janë të martuar, ja detaji që i zbuloi

Kanë qenë të shumtë zërat lartë e poshtë për martesën e tyre, por deri para pak kohësh kemi parë vetëm një unazë dhe kaq! Ndërkohë që tani mund të themi me siguri që reperi Stresi dhe Keisi tashmë janë burrë e grua. Përmes një foto të certifikatës familjare ka qenë vetë Keisi, e cila ka treguar se tashmë është pjesë e tringut të familjes Lushaj. Edhe pse këto kohë është diskutuar për ndarje mes tyre, duket se diçka e tillë nuk ka ndodhur. Tanimë Keisin do të duhet ta quajmë "Zonja Lushaj". Urime! Po ceremonia madhështore (apo sekrete) kur do të zhvillohet?



Kalojnë përvjetorin e parë të martesës në Kubë, Marina përdor fotoshop?

Vetëm para një viti çifti i njohur lidhi kurorë në një ceremoni pikante në Gjirin e Lalzit dhe po buzë detit, duket se ka vendosur të kremtojë dhe përvjetorin e parë të martesës. Vetëm se shumë larg prej këtej. Destinacioni i dyshes së famshme të showbizit duket se është Kuba. Që prej datës 10 shtator, në përvjetorin e parë të martesës së tyre, Geti dhe Marina janë arratisur së bashku për të festuar ku më mirë se në Kubë këtë përvjetor të parë. Ndërkohë ajo që bie në sy janë fotot që Marina poston në 'Instagram' ku mesa duket nuk i ka shpëtuar tentacionit të fotoshopit, aq të përhapur ditët e sotme nëpër rrjetet sociale. Në këmbën e saj të djathtë duket sikur këmba është më e dobët se këmba tjetër. Të jetë e nevojshme një ndërhyrje e tillë në trupin e bukuroshes? Shikoni dhe gjykoni vetë!



PRINDËR PËR HERË TË PARË, FOTOT E 9 MUAJVE TË SHTATZËNISË

U konfirmua!

Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa në pritje të një djali

EKSKLUZIVE

Pamela Aliaj

J o më larg se para një jave në Amfiteatrin e Tiranës është organizuar një mbrëmje speciale në nder të 30-vjetorit të krijimit të "Elita 5". Me pjesëmarrjen e një grupi vërtet elitari, koncerti ka qenë madhështor e ka mbledhur rreth vetes admiruesit e muzikës së grupit të njohur ku të gjithë kanë shijuar tingujt e hiteve ndër vite. Në koncert nuk kishin se si të mungonin edhe kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj me bashkëshorten e tij. Ka qenë pikërisht ai që ka publikuar foto nga koncerti ku ajo që më tepër ka rënë në sy është në forma e shkëlqyer e Ajolës, e cila është në ditët e fundit të pritjes së ëmbël. Por shumë thashetheme janë bërë lidhur me gjininë e fëmijës së tyre të parë që shumë shpejt do të vijë në jetë. Burime për "Bluetooh" të "Gazeta Shqiptare" kanë konfirmuar përfundimisht se fëmija i parë është djalë. Dyshimeve të shumta dhe hamendësimeve u erdhi fundi! Që nga një qershor kur për herë të parë ishte vetë kryebashkiaku që konfirmoi zërat për një shtatzëni, kësaj radhe ka qenë bashkëshortja ajo që ka dashur ta fshehtë rritjen e barkut duke u shfaqur gjithnjë në eventet e ndryshme, përfshirë edhe këtë të fundit në Tiranë, me fustane të zinj. Ndërkaq mund të themi padyshim se kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj, dhe bashkëshortja e tij, Ajola Xoxa, janë një prej çifteve më jetëgjatë të ekranit. Nëpërmjet lidhjes së tyre më shumë se 15-vjeçare, ata gjithmonë kanë ditur të përcjellin për publikun energji

Pak ditë para se të lindë, si duket bashkëshortja e kryebashkiakut të Tiranës




mjaft pozitive. Në projektet e shumta që i ka dedikuar sistemit të kryeqytetit, ai është përballur shumë me kontaktet me fëmijët dhe për këtë është ngacmuar shumë nga mediat se kur do të bëjë fëmijën e tij. Pak kohë më parë i ftuar në emisionin "Në kurthin e Piter Pan", Erioni tregoi se fëmijën ja kanë lënë kohës. Por duket se ky moment më në fund ka ardhur. Këtë fund shtatori ai dhe Ajola do të bëhen prindër për herë të parë të një vogëlushi. Padyshim që periudha e shtatzënisë është një nga periudhat më të bukura të një femre. Në këto nëntë muaj, trupi i një femre përjeton ndryshime të mëdha, por prita e ëmbël sjell, gjithashtu, ndjesi shumë të bukura shpirtërore. Këtë e ka treguar edhe Ajola Xoxa, e cila muaj pas muaji në mënyrën e saj postonte në 'Instastory' foto të përjetimeve të saj të veçanta të shtatzënisë. Ndërkohë që kujtojmë se ishte pikërisht 1-qershor dita që kryetari i Bashkisë së Tiranës Erion Veliaj vendosi të jepte lajmin se ai dhe Ajola janë në pritje të fëmijës së tyre të parë. Ai në një foto të postuar në 'Instagram'-in e tij shkruante: "Gëzuar 1 Qershorin dhe nga ne te tre! Ju duam të gjithëve!". Edhe pak ditë dhe pritjes do t'i vijë fundi! Të gjithë presim me padurim të shohim edhe ç'emër do t'i vendosin djalit. Me siguri shqiptar dhe domethënës! Mbetet për t'u parë, edhe pak ditë...





Ç'po ndodh kështu? Ish-e dashura e deputetit nga Kosova publikon foto nudo

Ajo është një prej vajzave më të komentuar në mediat rozë. Iva Aliko sigurohet që të tërheqë vëmendjen tek ndjekësit e saj në rrjetet sociale duke postuar foto joshëse. Këtë radhe ajo është vënë sërish në qendër të vëmendjes për shkak të një fotoje nudo që ka publikuar në profilin e saj në 'Instagram'. Ajo bëri bujë që në fillim me deklaratën e saj të disa kohëve më parë ku deklaroi se ishte e dashura e një deputeti të njohur nga Kosova dhe se ky i fundit i kishte bërë dhuratë një apartament. Ndërkohë që këto foto komplet nudo mund të përktehen lehtë si një tërheqje e vëmendjes si gjithnjë që ndodh me lven.



'Kimikatë ka kudo', Olsi Bylyku tregon arsyen e largimit nga "Portokalli"

Vetëm para pak kohësh aktori i njohur në 'Portokalli' si Kimikati zbuloi se do të largohet drejt 'Klan Tv'. Olsi Bylyku ka zbuluar në një intervistë për 'Klan' arsyet e kësaj lëvizjeje. Ai ka shpjeguar se zgjodhi rrjetet sociale për ta ndarë lajmin me fansat pasi aty është komentuar shumë. "Në Tv Klan do të më shihni si Olsi Bylyku, pasi si Olsi m'u bë dhe ftesa", -ka thënë ai. Ndërsa për faktin që do punojë me kolegët që e kanë shoqëruar në 'Portokalli' dhe a do e lehtësojë kjo punën, Olsi ka thënë: "Kam besuar gjithnjë te Besi dhe Erioni, si një dyshe fantastike humori (dhe këtë gjë e kam shprehur gjithnjë), por nuk e shoh aspak më të lehtë, pasi më duhet të punoj shumë për të nxjerrë produktin që të gjithë kërkojmë të shohim çdo të diel". Kujtojmë se tre aktorët e spektaklit 'Portokalli' do të kenë një hapësirë të dedikuar në emisionin 'E diela shqiptare' që do të mbajë emrin "B.E Caffè".



Një tjetër dasmë në horizont! E vërtetiam tashmë: Elita dhe Gjiko do të martohen në...

Kanë gjithë verën që po mundohen ta mbajnë të fshehtë! Por dihet, njëri lajm rrëzon një tjetër! Një herë do martohen, pastaj "ç'është kjo martesë?", pastaj 23 shtatori dhe në fund e konfirmuar data 21 shtator. Elita dhe Gjiko, pas vrullit mediatic të ditëve të fundit, më në fund do të martohen dhe ky është lajm i vërtetë. Moderatorja e njohur nga Kosova, madje, është përfolur se është në pritje të fëmijës së parë me reperin Gjiko, me të cilin bashkëjeton prej kohësh, por lajmin askush nga të dy nuk e ka konfirmuar. Edhe pse askush nga çifti nuk ka dhënë asnjë detaj, lajmet marrin dhe nga miqtë apo edhe bashkëpunëtorët dhe po flasim pikërisht për mikun e ngushtë të tyre, këngëtarin dhe moderatorin Kosovar, Labinot Gashi. Imazhi i fundit që është bërë publik është ftesa, e cila konfirmon tashmë ceremoninë që do të mbahet të premten e ardhshme, më 21 shtator. Fotoja e siguruar nga Prive duket të jetë pjesë e familjes së reperit, Gjiko. Të jetë sekrete dhe kjo? Mezi presim të shohim një tjetër princeshë me pak bark të fryrë (ndoshta) që shkon drejt altarit!



Mozzik dhe Loredana në gazetën zvicerane pas bashkëpunimit të parë, pranojnë

SHTATZËNINË




Ditën e djeshme, reperi Mozzik dhe partnerja e tij Loredana kanë publikuar bashkëpunimin e tyre të parë. Kënga e tyre e titulluar 'Bonnie & Clyde' është publikuar në platformën "Spotify" dhe duket se i ka hapur rrugën shumë projekteve të tjera muzikore në të ardhmen. Të paktën kështu janë shprehur në një intervistë që dyshja ka dhënë për gazetën zviceriane, '20 Minuten'. Loredana ka treguar se ky bashkëpunim ishte menduar shumë kohë më parë, ndërkohë që janë duke punuar për këngët e reja si dhe për albumin e saj. Kjo e fundit është shprehur shumë e kënaqur që krahas kohës që kalojnë si partnerë në jetë me Mozzik, tashmë janë gjithmonë bashkë edhe në punë. Një tjetër detaj që çifti ka zbuluar ka të bëjë me koncertet e tyre. Dyshja do të përqendrohet tek puna për projektet e reja dhe këtë vit nuk do të jenë të pranishëm në koncerte. Kjo me siguri i detyrohet edhe faktit që Loredana thuhet të jetë shtatzënë, gjë që edhe u la të kuptohej edhe në intervistë. Të jetë e vërtetë?



Solli në jetë djalit dy javësh, ADELINA TAHIRI tregon trupin në superformë pas lindjes



Jo më larg se para dy javësh, këngëtarja shqiptare Adelina Tahiri është bërë nënë. Ajo i ka shijuar këto momente të të qenit nënë dhe ka ndarë me fansat shpesh herë foto të vogëlushit. Por që prej festës së bebit, ne nuk kishim parë asnjë foto të Adelina, të paktën deri dje. Këngëtarja na e plotësoi dëshirën duke na treguar linjat e pas lindjes. Në një video në 'Instagram' ajo shfaqet e veshur e gjitha me të zeza, dhe na duhet të themi që nuk shohim ndonjë ndryshim të madh. Nuk e dimë se cili ka qenë sekret i ardhjes në formë kaq shpejt, por presim që Adelina të na e tregojë në një postim të dytë. Për t'u marrë shembull! Ku iku gjithë ajo fryrje në trup dhe në fytyrë brenda dy javësh?



"Pse nuk komentoj dot tek fotot e tua?", Fiori Dardha bllokon ndjekësen, ja arsyeja

Vijon të jetë ende 'virus' opsioni "Më bëj një pyetje" i 'Instastory'. Të shpeshta janë pyetjet që ndjekësit i bëjnë vipave tanë duke shuar kuriozitetin lidhur me çdo gjë të tyre. Një ndër pyetjet që bëri më tepër përshtypje ka qenë pyetja e një ndjekëse të moderatores së njohur të "Boom", Fjori Dardha, ku kërkon të dijë pse nuk ka mundësi të komentojë tek fotot e moderatores. "Kam aktivizuar një opsion të veçantë, asgjë personale," shkruan Fiori. Të jetë vërtetë jopersonale? Ndërkohë që shumë shpejt presim që në "Boom", Fiori dhe Rozana Radi do të sjellin ndryshime me "Femzatat".



FANSI

kërkon ta rrëmbejë, reagon papritur Einxhel Shkira: Je vonë, ma kanë rrëmbyer zemrën!



Vijon të jetë ende 'virus' opsioni "Më bëj një pyetje" i 'Instastory'. Të shpeshta janë pyetjet që ndjekësit i bëjnë vipave tanë duke shuar kuriozitetin lidhur me çdo gjë të tyre. Një ndër pyetjet që bëri më tepër përshtypje ka qenë pyetja e një ndjekësi, i cili i kërkoi që ta rrëmbejë Einxhel Shkirën. Por përgjigjja e saj ka tërhequr vëmendje. "Je vonë, ma kanë rrëmbyer zemrën!" Të jetë e vërtetë apo një shaka tjetër e moderatores bukuroshe?

Kleriku, apel prindërve dhe arsimtarëve: Edukojini dhe mësojini fëmijët!

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Myftiu i Shkodrës, Muhamed Sytari: Po na ikën për duarsh gjuha jonë kombëtare

"Arsimi ndodhet përballë sfidave të mëdha, në kohët e qytetërimeve askush s'guxonte të tallej me mësuesit"

Myftiu i Shkodrës, imam Muhamed Sytari gjatë hytbes në faljen e së premtes nga xhamia e Parrucës për situatën e arsimit në Shqipëri ka dhënë disa mesazhe të forta. Në prag të nisjes së sezonit shkollor dhe akademik, Sytari tha se arsimit ndodhet përballë sfidave të mëdha, ku nga njëra anë janë mësuesit, të cilëve u mbetet një barrë e madhe dhe nga ana tjetër janë prindërit, në dilemë për zgjedhjen e shkollave dhe të ardhmen e fëmijëve. Myftiu bëri apel që të rinjtë t'i kushtojnë një rëndësi të veçantë rrugës së dijes, pa harruar apelin për shkatërrimin sipas tij që po pëson gjuha shqipe dhe që duhet të ndalet sa më parë. Gjatë faljes së të premtes në xhaminë e Parrucës në Shkodër morën pjesë përveç besimtarëve të zakonshëm, edhe nxënës e studentë, si dhe mësues të shkollave 9-vjeçare, të mesme dhe pedagogë të Universitetit të "Luigj Gurakuqi". "Një tërheqje vëmendjeje për sojin tim, për rininë, për fëmijët tanë në këtë fillim viti shkollor dhe fillim viti akademik për të respektuar dijen dhe dijetarët. Në kohët e qytetërimeve askush nuk guxonte të ngrinte dorë kundër mësuesit, askush nuk mendonte ta thërriste në emër, të tallej apo ta fyente mësuesin, askush nuk mendonte për t'i bërë kamera të fshehta mësuesit për ta bërë objekt qesharak. Sfidat e mësuesit është të ruajë këtë ekuilibër të madh të besimit dhe qytetarisë, të ruajë këtë ekuilibër të madh të vlerave tona kombëtare dhe fetare, të ruajë këtë ekuilibër të madh të një brezi, i cili ka më shumë se kurrë nevojë për ndërhyrjen e njerëzve të urtë dhe të ditur për t'i shpëtuar brezat dhe rininë tonë nga tentakulat e së keqes, prej së cilës kërcënohet çdo ditë."

SFIDA

Myftiu i Shkodrës u shpreh dje se, "në kohët e qytetërimeve askush nuk guxonte të ngrinte dorë kundër mësuesit, askush nuk mendonte ta thërriste në emër, të tallej apo ta fyente mësuesin, askush nuk mendonte për t'i bërë kamera të fshehta mësuesit për ta bërë objekt qesharak. Sfidat e mësuesit është të ruajë këtë ekuilibër të madh të besimit dhe qytetarisë, të ruajë këtë ekuilibër të madh të vlerave tona kombëtare dhe fetare, të ruajë këtë ekuilibër të madh të një brezi, i cili ka më shumë se kurrë nevojë për ndërhyrjen e njerëzve të urtë dhe të ditur për t'i shpëtuar brezat dhe rininë tonë nga tentakulat e së keqes, prej së cilës kërcënohet çdo ditë."



Myftiu i Shkodrës, imam Muhamed Sytari

LUTJA

Imami Muhamed Sytari bëri një lutje për gjithsecilin prej prindërve dhe fëmijëve që të kenë vëmendjen tek fëmijët që t'ua mësojnë bukur gjuhën shqipe. "Po na ikën gjuha shqipe për duarsh, po na ikën gjuha jonë kombëtare, këtë gjuhë, me të cilën na ka veçuar Zoti nga krejt popujt e tjerë të botës, po na ikën për duarsh në një mënyrë apo tjetër, po na masakrohet gjuha, po na bastardohej trashëgimia kombëtare, po na bastardohej traditat kombëtare, tabani kombëtar i vlerave dhe njerëz pa traditë. Pa taban e trashëgimi nuk gjen në asnjë vend të botës veç ata që janë larguar nga kjo botë dhe nuk kanë asgjë", u shpreh ai.

ijët. Jo materialisht - tha myftiu - por për t'u vjedhur mendjen, për t'u vjedhur shpirtin, për t'u devjuar besimin, për t'i nxjerrë nga drita e besimit në errësirën e mohimit, për t'i nxjerrë nga drita e vlerave, tabanin e trashëgimisë islame drejt injorancës, drejt primitivizmit dhe drejt një modeli që nuk mund të jetë premtues për të ardhmen e asnjë brezi. Më pas, myftiu foli edhe për sfidën e mësuesve të sotëm, që është sipas tij për të edukuar një brez, i cili

tri i drejtë dhe moral i këtij vendi, politikanin i drejtë dhe moralin i këtij vendi, deputetin moral dhe i drejtë i këtij vendi, do të jetë ministri moral dhe i drejtë i këtij vendi, do të jetë myftiu moral dhe i drejtë i këtij vendi, kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë i urtë, i drejtë dhe i posaçëm në atë pozicion i këtij vendi, pra do të jetë e ardhmja. Nëse ne sot neglizhojmë farat e së nesërme - këshilloi myftiu i Shkodrës - askush të mos ketë habi pastaj nëse pas disa vitesh

tin, nuk njej bazën morale, nuk njej tabanin kombëtar, por njej vetëm të qenurit misionar i dikujt dhe diçkaje që njerëzit nuk e shohin dhe ajka e dijetarëve e dinë, por shumica e njerëzve heshitin dhe nuk flasin dhe shumica shkojnë në turmë si turmat që nuk dinë ku shkojnë dhe kush i drejton.

APELI

Në fund të fjalës së tij, myftiu i Shkodrës, Muhamed Sytari iu drejtua mësuesve dhe edukatorëve të shtrenjtë, duke u thënë ama-

nga dija e padobishme, e cila sjell korrupsion dhe sjell aty ku nuk duhet njerëz, të cilët shkatërrojnë vendin dhe prishin pasuritë e tij. Një shoqëri që nuk vlerëson dijetarët, mësuesit dhe edukatorët, një shoqëri që nuk interesohet që fëmijët e saj të lartësohen në gradët e shkollave më të larta të dijes dhe nxënies së saj është një shoqëri e destinuar për t'u shkatërruar siç janë shkatërruar shumë shoqëri të tjera u shpreh myftiu", pohoi Sytari. Në mbyllje, ai bëri një lutje për gjithsecilin prej prindërve dhe fëmijëve që të kenë vëmendjen tek fëmijët që t'ua mësojnë bukur gjuhën shqipe. "Po na ikën gjuha shqipe për duarsh, po na ikën gjuha jonë kombëtare, këtë gjuhë me të cilën na ka veçuar Zoti nga krejt popujt e tjerë të botës, po na ikën për duarsh në një mënyrë apo tjetër, po na masakrohet gjuha, po na bastardohej trashëgimia kombëtare, po na bastardohej traditat kombëtare, tabani kombëtar i vlerave dhe njerëz pa traditë. Pa taban e trashëgimi nuk gjen në asnjë vend të botës, veç ata që janë larguar nga kjo botë dhe nuk kanë asgjë", përfundoi mesazhin e tij myftiu i Shkodrës, imam Muhamed Sytari.

DEKLARATA

"Çdo mësues le të jetë vlerë, të jetë sakrifikes, të jetë model, të jetë pikë referimi për fëmijët tanë. Jo të mendojmë të kundërtën. Një shoqëri që nuk vlerëson dijetarët, mësuesit dhe edukatorët; një shoqëri që nuk interesohet që fëmijët e saj të lartësohen në gradët e shkollave më të larta të dijes dhe nxënies së saj është një shoqëri e destinuar për t'u shkatërruar, siç janë shkatërruar shumë shoqëri të tjera u shpreh myftiu", deklaroi Sytari.

më së shumti ka nevojë për mësuesin edukator. Myftiu Sytari deklaroi se fëmija dhe i riu që është para duarve të mësuesit, nesër do të jetë mjeku i së ardhmes, politikanin i së ardhmes, presidentin i së ardhmes, kryeminis-

modelet hibride do të drejtojnë Shqipërinë dhe ta marrin përdore drejt dekadencave më të mëdha se sa ka rënë sot Shqipëria si pasojë e një keqformimi, si pasojë e këtij keqdukimi, si pasojë e një formimi që nuk njej Zo-

net fëmijët e këtij vendi dhe amanet fëmijët e Shkodrës. "Çdo mësues le të jetë vlerë, të jetë sakrifikes, të jetë model, të jetë pikë referimi për fëmijët tanë. Jo të mendojmë të kundërtën. Duhet të lutemi që Zoti të na ruaj

Tentoi të vriste të riun para 4 muajsh, prangoset 48-vjeçari

SHKODËR - Policia dhe Forcat e Ndërhyrjes së Shejtit të Shkodrës kanë arrestuar një 48-vjeçar, i cili katër muaj më parë ka tentuar të vrasë një person. Bëhet fjalë për Lulzim Hasanajn, i cili në muajin maj të këtij viti ka plagosur me armë zjarri 32-vjeçarin Ylli Berisha, banues në fshatin Kamicë të Malësisë së Madhe. Sipas bluve, falë një pune intensive hetimore dhe në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative u bë e mundur kapa e 48-vjeçarit. Ndalimi i tij u bë, pasi Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër më 29 maj të këtij viti ka vendosur masën e sigurimit personal "arrest në burg" për veprat penale të "Vrasjes me dashje, në tentative, kryer në bashkëpunim" si dhe "Prodhimin dhe mbajtjen pa leje të armëve dhe municioneve luftarakë". Policia bëri të ditur se Lulzim Hasanaj është bashkautor në plagosjen me armë zjarri të Ylli Berishës, ngjarje kjo e ndodhur në 5 maj të këtij viti në fshatin Kamicë të Malësisë së Madhe. Plagosja e 32-vjeçarit erdhi pas një konfliktit me vëllezërit Hasanaj në fshatin Kamicë. E gjithë ngjarja ndodhi, pasi Berisha tentoi që të futej në liqenin e Shkodrës për të zënë peshk në afërsi të fshatit Kamicë. Teksa kanë parë 32-vjeçarin, dy vëllezërit Hasanaj kanë nisur që të debatohet me të duke i thënë se ai nuk duhet të futej në atë zonë të liqenit, sepse ishte zona ku ata peshkonin. Ylli Berisha ka kundërshtuar duke i thënë se në liqen gjithsecili ka të drejtë që të shkojë. Në sherr e sipër, 48-vjeçari Lulzim Hasanaj dhe vëllai i tij kanë qëlluar dhe kanë plagosur 32-vjeçarin.

Opinion *i* Ditës

Pse tani dhe cila është domethënia e demonstrimit ushtarak ruso-kinez?

Nga Vasil Kureta

(vijon nga faqja 1)

...stërvitje tepër të madhe ushtarake, të koduar "Vostok 2018", nga Rusia marrin pjesë 300.000 trupa, 36000 automjete ushtarake, 1000 avionë dhe 80 anije ushtarake. Kina merr pjesë me 3200 trupa. Koha e zgjedhur, vendi i zhvillimit, shumëllojshmëria e sasia e armëve dhe trupave në stërvitje, veprimet ushtarake të programuara, pjesëmarrja e Kinës edhe pse me numër më të vogël trupash dhe armësh, kanë domethënie të tyre e që të mundësojnë të mësohen më tepër apo përtej atyre objektivave ushtarake të deklaruara publikisht nga Rusia.

Përmes shefit të shtabit të përgjithshëm Valeri Gerasimov, Rusia deklaroi se, qëllimi i stërvitjes është mbrojtës apo se "manovrat tona nuk janë të drejtuara kundër vendeve të tjera dhe janë në përputhje me doktrinën tonë ushtarake, e cila është mbrojtëse". Pas këtij deklarimi publik të ushtarakut të lartë rus, vetu lind pyetja: pse tani kjo stërvitje apo cilët janë motivet që e kanë programuar kohë më parë atë dhe në këto përmasa? A ka ndonjë kërcënim serioz ndaj Rusisë apo kush mund ta ketë kërcënuar apo rrezikuar Rusinë, që e detyron atë t'i tregojë muskujt e forcës së saj? Pse Rusia e zhvillon atë së bashku apo me pjesëmarrjen e Kinës apo pse ka ftuar Kinën? Pse Kina ka vendosur të pjesëmarrë në këtë demonstrim të dukshëm ushtarak e force, të programuara nga Rusia? Është kjo stërvitje e programuar me kohë nga Rusia, që ka ftuar si fqinj edhe Kinën, apo është një stërvitje e dakordësuar apo iniciuar bashkërisht, për të kryer këtë demonstrim të forcës ushtarake, në funksion të objektivave gjeostrategjike?

Pse Kina i bashkohet Rusisë në këtë demonstrim jashtëzakonisht të madh muskujsh? Çfarë interesash mund të ketë Kina në rajonin e Siberisë apo të Arktikut? Vërtet Kina është bërë pjesë e një organizimi ushtarak, të krijuar nga Rusia, por, kjo stërvitje nuk deklarohet si aktivitet i këtij organizimi. Pse Kina e bën këtë lëvizje bashkë me Rusinë, kur në historinë e marrëdhënieve mes tyre ka dhe një ngjarje të rëndë në kufirin mes tyre, në periudhën komuniste? Pse kryhet kjo stërvitje pas takimit të Putinit me Trump, ku u deklaruan për marrëdhënie bashkëpunimi? A ka ndikim në zhvillimin e këtij demonstrimi force ushtarake grindja brenda perëndimit, ajo mes SHBA dhe BE, por dhe brenda BE apo edhe sanksionet e deklaruara ndaj Kinës dhe Rusisë? Pra, ka shumë "pse" dhe jo rastësisht, aq më tepër që bëhet fjalë për dy vende të mëdha si Rusia e Kina, që kanë rivalizuar fort për ndarje të fuqisë dhe rolit



me SHBA. Pra, pse tani ky demonstrim i fuqisë ushtarake nga dy aktorë të mëdhenj në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare, që shënon një zhvillim historik për këto dy fuqi bërthamore, pse me këto përmasa dhe pse së bashku, aq më tepër kur Kina në të kaluarën ka qenë kundër ushtrimeve ushtarake të Rusisë?

Është fakt që, si Rusia edhe Kina kanë avancuar shumë në sigurimin e një statusi të superfuqisë botërore apo thënë edhe në rivalitetin me SHBA, apo në ndarjen e fuqisë me të. Megjithatë, të dy këto fuqi të mëdha, nuk mund të konkurrojnë dot, sidomos me modelin perëndimor të zhvillimit, por as dhe me perëndimin edhe në situatën e sotme të grindjes, që zhvillohet brenda tij. Kjo rrethanë i bën të ngutur në arritjen e objektivave gjeostrategjike, apo që synojnë të marrin maksimumin në këtë proces. Realizimi

i rolit presupozon elementin ekonomik, politik, kulturor etj., por fuqia ushtarake është element thelbësor roli. Ka aktualisht një problematikë të hapur me aneksimin e Krimesë, konfliktin në lindje të Ukrainës, apo me krizën gjeorgjiane, që solli dhe dy republika të vetëshpallura të mbështetura nga Rusia, siç ka dhe një problematikë komplekse e të vështirë si gadishullin korean apo edhe në rajonin e paqësorisht, ku qëndrimi korrekt i Perëndimit, në mbrojtje të rendit botëror e ligjit ndërkombëtar, i ka vënë në vështirësi këto vende në realizimin e objektivave gjeostrategjike e për një rol superfuqie në zhvillimet ndërkombëtare.

Që nga deklarimi i Putinit, që e vlerësoi si katastrofën më të madhe gjeopolitike shpërbërjen e BS, Rusia ka avancuar dukshëm në definimin e objektivave gjeostrategjike dhe gradualisht ka nguritur e trashur zërin e saj, siç po

bën edhe me deklarimet që kundërshtojnë avancimin e procesit të anëtarësimit në BE e në NATO të Gjeorgjisë dhe Ukrainës. Strategjia e konflikteve të ngrira me rastin e krizës gjeorgjiane dhe asaj në lindje të Ukrainës, siç duket e kreu misionin e saj dhe tash duket se ka lindur nevoja për hapa të tjerë. Rusia, gjithashtu, e sheh si nevojë esenciale të sigurojë një rol të dukshëm në hapësirën europoriane, që deri më sot e ka pasur shumë të vështirë. Edhe pse Rusia pret shumë nga grindja brenda Perëndimit e sidomos brenda BE, apo që e shpreson një shpërbërje të BE, ajo është e vendosur të futet në forma bashkëpunimi, sidomos ekonomik e energjetik aktualisht, me qëllim që të sigurojë një rol real europorian. Nuk është fjala vetëm të çlirohet nga sanksionet e Perëndimit për aneksimin e Krimesë dhe konfliktin në lindje të Ukrainës, por për

të mundësuar një zhvillim cilësor të interesave ekonomike, politike e strategjike në hapësirën europoriane. Komponenti i forcës ushtarake vlerësohet kështu si një element i rëndësishëm i sigurimit apo imponimit të rolit. Rusia ka bërë investime shumë të mëdha edhe në infrastrukturë, përfshi dhe atë ushtarake në rajonin e pasur dhe shumë strategjik të Arktikut, ku pret të përballlet me interesat edhe të vendeve të tjera, që deri më sot nuk kanë reaguar sa duhet, por që do të reagojnë në të ardhmen. Po kështu, Rusia nuk është pajtuar kurrë me anëtarësimin në NATO të tre vendeve baltike, që dikur ishin pjesë e BS, por dhe këto vende kanë qenë shumë sionisteve ndaj veprimeve edhe ushtarake të Rusisë, në kufi me to, duke e ngritur zërin brenda aleancës euroatlantike e duke folur hapur për rrezik apo kërcënim nga Rusia. Rusia nga ana e saj anëtarësimin e këtyre vendeve në BE e veçanërisht në NATO, por dhe mundësinë e anëtarësimit të Gjeorgjisë dhe Ukrainës në këto organizma e ka vlerësuar publikisht si "rrethim" që perëndimi po i bën Rusisë. Të gjitha këto janë lëndë që dëshmojnë, si interesa gjeostrategjike të Rusisë, por edhe që të mundësojnë të kuptosh këtë demonstrim kaq të fuqishëm ushtarak në Siberi dhe pranë Arktikut e Baltikut.

Rusia ndjek me vëmendje grindjen SHBA-BE duke u përpjekur të shtrijë marrëdhënie konkrete ekonomike, ku nafta dhe gazi janë njëherësh armë ekonomike e gjeopolitike. Rusisë i intereson shumë që, grindja SHBA-BE të thellohet, sepse kështu krijohen mundësi e hapësira konkrete ndikimi e roli, por edhe për t'u lehtësuar në aksione konkrete në funksion të interesave gjeostrategjike. Rusia përpjeket shumë të çlirohet nga sanksionet ekonomike të perëndimit, prandaj dhe lëviz të mbështetës lëvizje e parti politike që shprehin kundër avancimit të projektit europorian. Po kështu, Rusia ka interes që projekti europorian të dështojë, prandaj dhe siç dëshmojnë mediat, është investuar në mbështetje të partive politike të profilit nationalist e euroskeptik. Nuk kanë munguar nga krahë të këtyre partive politike edhe nga ata që kanë fituar zgjedhjet si në Itali, që kanë kërkuar heqjen e sanksioneve ndaj Rusisë dhe që shprehin për avancim të marrëdhënieve ekonomike e bashkëpunimi me Rusinë. Natyrisht, që nuk ka hapësira bosh që të shtrish rolin, por kjo nuk do të thotë që nuk krijohen mundësi për të shtuarur një rol konkret, jo vetëm ekonomik, por edhe politik e ushtarak. Dhe rajoni i Ballkanit është sot një hapësirë reale rivaliteti, ku Rusia, por edhe Kina e domojnë një rol konkret, prandaj dhe kanë bërë e po bëjnë hapa konkretë. Rusia →

Opinion i Ditës

Shqiptarët e Shqipërisë dhe Kosova

Nga Liliana Hoxha

(vijon nga faja 1)

...Po sa konkretisht jemi të tillë? Nuk mund të jemi, se na ndan politika duke na mbajtur në ob-skuritët. Për këtë qëllim inteligjenca detyrohet të mbetet e munguar. Për fat të keq, por edhe të mirë vetëm Berisha qëndron i fuqishëm dhe krejtësisht transparent. Aktualisht, duam apo s'duam, ai përfaqëson së paku inteligjencën shqiptare kryesisht për Kosovën, jo vetëm për sot, por që nga viti 1977 kur e kam njohur, aq më tepër si lider krahasuar me truket e të tjerëve maskuar me retorika apo me heshtje për çështje të nxehta si kjo, heshtje që bërtet më shumë se cicërimat e tyre prej trishtili në "Twitter". Për problemin e korrigitimit të kufijve, që realisht është një pretendim apo politikë ekspansive, në krah të Vetëvendosjes, apo të Albin Kurtit, qëndron krenarisht vetëm Berisha prej idealit të përbashkët për çështjen kombëtare, ndonëse njëri përgjithësisht shkon majtas e tjetri shkon djathtas. Çfarë e pengon qeverinë e majtë shqiptare të mbrojë interesat e Kosovës? Në korrigitjen e qendërmeve e politikave aktuale me përmbajtje jo neutrale të Serbisë, Europës e Rusisë, shqiptarët mbeten në injorancë të diktuar siç e do interesi i politikës. Por gjithkush mund të ndërjegjësohet mjaft që ta shqetësojë kjo çështje mbarë shqiptare.

Një referencë cilësore e castit jo po kalojmë është pozicioni informativ, kulturor e tradicional i



Berishës në emisionin 'Opinion' të Fevziut në 13 shtator. Mua nuk më mbetet asgjë për të shtuar veç t'iu rikujtoj shqiptarëve se çështja e korrigitimit të kufijve që mbrohet kaq fort me mënyrat që përmenda, fsheh të vërteta shumë të hidhura që askush nga politika shqiptare nuk i përmend. Mitrovica synohet prej serbëve goja prej mbipopullatës serbe ndaj asaj shqiptare në atë truall. Ndërkaq serbizimi i Mitrovicës është bërë me qëllim që sot të synohet si pretendim i pafajshëm gjeografik dhe kështu po trajtohet nga politika "in-

teligjente" e Shqipërisë e Kosovës. Në fakt, duhet bërë i fort se Mitrovica ka Treppen, minierën më në zë në Ballkan, që ish-të pasuria kryesore e gjithë ish-Federatës së bashkuar të Jugosllavisë e jo më sot e Serbisë. Minierë kjo që nuk shtron dhe e pasosur ndonjëherë prej xeheroëve me përmbajtje e përqindje të lartë të metaleve të rralla apo të çmuara. Ndaj serbet nuk do ta njohin kurrë Kosovën pa marrë Mitrovicën. Në vitin 1989 minatorët e Treppes ngritën krye për të drejtat e tyre. Kjo e tundi në themel ish-Federatën

Jugosllave. Në atë kohë punoja si zv drejtorë e ATSH. Jetonim ditë e natë me minatorët e Treppes, me prurje lajmesh të nxehta, ndërsa politika shqiptare e Ramiz Alisë, doemos pas vdekjes së Enver Hoxhës, ishte goja me kryengritësit një-lloj siç është sot politika shqiptare goja me interesin e Kosovës përfaqësuar nga Thaçi.

Për të mos e tjerë artikullin siç e ka zakon politika e masmedia e saj për të mos thënë realisht atë që duhet, mjafton të përmend:

Vuçiç nuk u lejua të hyjë në Drenicë. Shqiptarët e Drenicës kishin zënë sa gjatë e gjerë rrugën me pretendimin sa legjitim aq minimal që t'iu kërkohet ndjesë për masakrat e Drenicës, për gjakun ende të pa tharë të brezave të familjeve të zhdukur nga serbet. Ramush Haradinaj, më sensitiv në këtë çështje, e pengon zyrtarisht vizitën e Vuçiç. I tërhequr mbrapsht, Vuçiç reagon me fjalimin që do të mbetet historik sikur shqiptarët e Kosovës e Shqipërisë të mos harrojnë. Deklaratat e tij ishin ekstreme:

"Kosovën nuk do ta njohim kurrë

-Ngriti kultin e Milosheviçit edhe pse Drenica si e gjithë Kosova ishte veprë e tij. Edhe pse Gjyqi i Hagës e ka quajtur "Kasapi i Ballkanit"

-Kundrejt pengesës paqësore në Drenicë, ai nuk mendoi dy herë për të kërcënuar që po të jetë nevoja do të ndërhyjë ushtarakisht.

Sa europianiste janë këto deklarata kundrejt heshtjes së politikës shqiptare?

ka avancuar ndjeshëm me bazën e instaluar në Nish, me dhënien e statusit të vëzhguesit të Serbisë në organizim ushtarak euroaziatik, marrëveshjet konkrete edhe në lëmin ushtarak e stërvitjet e përbashkëta të kryera deri më sot. Sot flitet hapur në hapësirën ballkanike për interesim të lartë të Rusisë për ndikim në këtë rajon edhe pse Rusia i ka përgjeshtruar ato. Nga ana e saj Kina me projektin e rrugës së mëndafshit e projektet për investime në infrastrukturë, investimet në portin e Pireut etj., synon të avancojë rolin e saj në Europë. Pikërisht, se ka vlerësuar maksimalisht elementin e fuqisë ushtarake, Rusia doli vrullshëm në krizën siriane edhe pse kishte dhe një kusht të madhe ekonomike, financiare e ushtarake. Dhe, në fakt, Rusia e ka siguruar tashmë një rol të saj në rajonin e lindjes së Mesme, duke shtuar kështu një element të përbashkët të rolit të Rusisë në zhvillimet botërore.

Rusia është pranë Paqësorit dhe Azisë, por në këtë hapësirë ajo aktualisht e ka shumë të vështirë të depërtojë e të sigurojë një rol konkret. Atje nuk ka përballë vetëm SHBA dhe Perëndimin e

fuqi të tjera, por edhe aleatin aktual të saj Kinën. Kina nga ana e saj ka mundësuar një rol në Azi, ku nuk ka gjetur ndonjë kundërshtim serioz nga SHBA, por një synim i rëndësishëm i saj është rajoni i paqësorisht dhe gadishullit korean. Rusia e mendon një mbështetje nga Kina të interesave të saj e rolit në hapësirën europiane, siç e kupton mirë interesin e Kinës në rajonin e paqësorisht, përfshi dhe një mbështetje të saj për Kinën. Të dyja këto fuqi kanë nevojë sot për mbështetjen e njëra-tjetrës në plotësimin e ambicieve imperiale e të superfuqisë, të rolit të tyre në zhvillimet botërore.

Me pjesëmarrjen e saj në këtë stërvitje ushtarake, Kina ka shprehur kështu mbështetjen e saj për interesat gjeopolitike të Rusisë në hapësirën europiane. Të dyja kanë shumë nevojë për njëra-tjetrën sot në avancimin e interesave konkrete, për të përfutur më shumë hapësirë e në marrëdhëniet me perëndimin. Kina ka avancuar dukshëm në zhvillimin e rolit të saj në hapësirën e paqësorisht edhe me ishujt artificialë të fortifikuar ushtarakisht, për të cilat Rusia nuk ka shprehur ndonjë kundërshtim, siç kanë bërë disa

finqinj të Kinës dhe SHBA e Perëndimi. Kina nuk mund të mos e vlerësojë këtë qëndrim të Rusisë. Është interesant dhe i kuptueshëm qëndrimi dhe sjellja e Rusisë ndaj zhvillimit më të fundit të marrëdhënies mes SHBA e Koresë së Veriut, ku ka njohur, në fakt, rolin e Kinës në këtë gadishull. Me këto veprime e qëndrime të afruara mes tyre, duket që si Rusia ashtu dhe Kina synojnë të certifikojnë zonat e tyre të interesave gjeostrategjike, në rivalitetin për një rol botëror në sistemin e marrëdhënies ndërkombehtar, por dhe të dakordësuaras mes tyre. Në këtë kuptim kjo stërvitje e përbashkët ushtarake është një mesazh i qartë ndaj Perëndimit, ndaj SHBA dhe BE, një qëndrim i përbashkët edhe ndaj sanksioneve konkrete ekonomike e financiare nga Perëndimi e SHBA. Koha e zgjedhur tani gjykohejt si efektive, kur grindja brenda perëndimit ka avancuar shumë, kur SHBA shfaqen të vendosura në sendërtimin e "AmericaFirst". Mendohet se nga kjo situatë mund të përfitohet shumë për afishimin e objektivave e interesave konkrete gjeostrategjike, për secilin prej tyre, shoqëruar kështu dhe me

mbështetjen e secilit për to. Kina e kërkon mbështetjen e Rusisë në këtë moment, në përballimin e sanksioneve të adresuara nga SHBA, kur nuk mundi të sigurojë një mbështetje konkrete e efektive nga BE, apo vende të veçanta europiane. Edhe pse Kina ka qenë shumë e kujdesshme në drejtim të cilësive së marrëdhënies me SHBA dhe avancimin e objektivave të superfuqisë botërore, duket se e ka vlerësuar të përshtatshëm këtë demonstrim dashurie me Rusinë për të adresuar një lloj presioni ndaj SHBA.

Si Rusia ashtu edhe Kina e dëshirojnë një çarje reale e pakthim të Perëndimit e po kështu edhe një shpërbërje të BE, duke e menduar më efektive për të zhvilluar interesa konkrete gjeostrategjike për veten. Duket që Rusia dhe Kina dakordësohen mes tyre se, duhet të marrin maksimumin në këtë situatë grindjeje të Perëndimit e zhvillimeve të brendshme në SHBA dhe në BE. Madje ato llogarisin dhe alternativat e zhvillimeve të ardhshme ekonomike, sociale e politike brenda vendeve të tyre, që mund të jenë edhe të disfavorshme apo më pak të favorshme se aktualisht.

Më 14 shtator 2018

HOROSKOPI

DASHI

Do të përballemi me disa probleme që do t'ju shqetësojnë shumë. Bëni mirë të bëni pushim dhe të qetësoheni. Do të realizoni disa plane të rëndësishme, të cilat do t'ju sjellin mjaftueshëm të ardhura. Do të kaloni një ditë të mrekullueshme me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj.

DEMI

Do të realizoni një udhëtim shumë të këndshëm me miqtë tuaj. Kontrolloni sjelljen pasi mund të mërzisni familjarët. Ka gjasa të nisni një marrëdhënie të re romantike. Do të kënaqeni pafund, kur të përfundoni një projekt, të cilin e keni nisur shumë kohë më parë.

BINJAKET

Do të ndëni mirë nga mbështetja që do t'ju japin miqtë tuaj. Miqtë do t'ju ndihmojnë ditën, pasi do të planifikojnë diçka shumë interesante në mbrëmje. Dëgjoni këshillat e tjerëve, nëse nuk doni të gaboni sot.

GAFORJA

Nëse tregoheni neglizhent do të përballemi më pas me disa probleme. Duhet t'kush-toni më shumë kohë vetes suaj. Ambienti në punë do të ndryshojë, duke iu bërë të ndihni shumë mirë.

LUANI

Duhet të ndaloni duhanin dhe të kryeni sa më shumë ushtrime fizike. Do të përfshihen në një situatë që do t'ju sjellë të ardhura. Është koha e duhur që të ndryshoni sjelljen dominante në familje. Përkundrazi, duhet të flisni me familjarët dhe të ndani shqetësimet tuaja. Nëse doni që të mos grindeni sot me bashkëshortin/bashkëshortin përqini të kontrolloni fjalët.

VIRGJERESHA

Është koha e duhur për t'u qetësuar. Meditimi dhe joga do t'ju ndihmojnë shumë për gjendjen tuaj psikologjike. Do të bëni mirë nëse vizitoni të afërmit tuaj. Është dita juaj më fat për dërguar CV-në dhe për të aplikuar në një vend të ri punë.

PESHORJA

Mos shpenzoni shumë kohë duke u përpjekur të impresiononi të tjerët. Mungesa e komunikimit me një person që u konsideroni të rëndësishëm, do t'ju mërzisë shumë. Është momenti për të kujtuar disa kohë të vjetra me miqtë tuaj. Partner/partnerja juaj do të tregohet më romantik se kurrë.

AKREPI

Përqini të bëni sa më shumë ushtrime fizike pasi do t'ju ndihmojnë të ndihni mirë fizikisht dhe psikologjikisht. Partner/partnerja juaj do të jetë i frijtuar sot, çfarë do t'ju shqetësojë edhe ju. Pritshmëritë e mëdha në jetën bashkëshortore do t'ju çojnë drejt trishtimit.

SHIGJETARI

Vëshirësitë me të cilat do të përballemi gjatë ditës së sotme, do t'ju bëjnë të ndihni i dobët. Koha e duhur për të kryer disa transaksione financiare. Do të jeni pjesë e një projekti të madh që të fitojë vlerësimin tuaj. Do të kryeni një bisedë romantike me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj.

BRICJAPI

Do të përballemi me disa probleme shëndetësore. Do të fitoni mjaftueshëm para sot, por rritja e shpenzimeve do të bëjë të mos kurseni. Përpjekjet për të përmirësuar look-un do të rezultojnë të suksesshme.


UJORI

Ndjekja e hobit tuaj do t'ju bëjë të relaksuar. Do të kaloni një ditë të qetë me familjarët tuaj. Qëndroni larg thashethemeve dhe punoni për disa projekte të rëndësishme. Do të kaloni një ditë të këndshme me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj, ku do të mbitotërojnë puthjet dhe përqafimet.

PESHQIT

Përqini të relaksoheni për të fituar energjinë e humbur. Duhet të kuptoni potencialin tuaj të vërtetë dhe të tregoni vullnet. Komunikoni sa më shumë partner/partneren tuaj që të zgjidhni mosmarrëveshjet dhe ndryshimet mes jush.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Parafjalë prejardhjeje.
- I përshtatshëm.
- Është sportive në garë.
- Fidel që thirret Lider Maximo
- Para Jack në flamurin britanik.
- Rodrigues që këndonte fado.
- Një pjesë e lartësisë.
- Vende pa ne.
- I është hequr të dënuarit.
- Ishte miku i famshëm i Orestit.
- Pak enigmatike.
- Janë pasuri të investuara
- Një pjesë e simpoziumit.
- U përmbyësën në Afganistan.
- Inicialet e Moravia-s.
- Ai B prek mëlçinë.
- Vritet në fund.
- Manchester i Alex Ferguson.
- Ai i trëndafilit është i Umberto Eco-s.

- Është zëri... i hekurit.
- Ai B është rezervë.
- Shkroi Një jetë e Jezusit.
- Është për medaljen e parë.
- Papas aktore.
- Thomson aktore.
- Tri të parat në atletikë.
- Kështu thirrej Marco Pantani.
- Dhanë alarmin në kapitoll

VERTIKAL

- Bëhet në stacion.
- Është irritimi.
- Argento aktore.
- Detarë pa erë.
- Në krye të armatës.
- Janë si meduza.
- Mbeten në bisht.
- Është gjendja e të martuarit.
- Pesci aktor.
- Kulmojnë më Akonkagua.
- Një Baba përrallor.
- Janë priftërinj
- Më e pakta.
- Rrëzon padinë një e tillë.
- Ishin kalorësoit si Rolandi.
- Poggi aktore.
- Një mund të jetë republike.
- Një material inert për çati.
- Janë ushtarakë të ulët
- Para parade në diskografi.
- Trimi pa çifte.
- E ardhmja më e afërt.
- U vra në banjë nga Corday.
- Një mund të jetë pushimi.
- Një lloj njeriu.
- Janë tek në numra.
- Fund janari
- Fillojnë nazet.
- Mbyllin portat.
- Nota e diapazonit.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Irene aktore.
- Gjysma e kulmit.
- Fillojnë vetëm.
- Qytet rumun
- Mund të jenë me sahat.
- Elliott Gould.
- Inicialet e Altman regjisor.
- Thomas Alva shpikës i famshëm.
- Lumë në Spanjë.
- Ndaheshin me sinorë.
- Zbuloi Tokën e Van Diemen.
- Kush nuk ka... nuk i ecën.
- Një kapak me titull.
- Inicialet e Turgeniev.
- Janë provat që administrohen.
- Na kanë paraprirë.
- Rubinstein që qe pianist.
- Fundi i një fukarali.
- Gardner aktore.

VERTIKAL


- Është material për qiri.
- Mali ku ngeci Arka e Noes.
- Fillojnë panikun.
- Një zakon.
- Gjysmë sistem.
- Janë zojt të verdhë.
- Në fund të krahut.
- Shkroi Michel Strogoff.
- Gjysmë egoist.
- Përbindëshi i labirintit.
- Vertetojnë firma të tillë.
- Erni i Zola.
- Është si shtëpi.
- Mbyllin portat.
- Ka tribuna me shkallë.
- Mund të jetë telefonike.
- Charles që krijoi Gishton.
- Pineda e Garcia Lorca-s.
- Janë të palëvizshmet.
- Aty ku del kush bie në sy.
- Ashtu si jeton anakoretit.
- Coca... më e famshme.
- Janë të ndryshme në leje.
- Është Civile Kavajë.
- Shkroi Misteret e Parisit.
- Beton pa kufij
- Kështu përfundon një princip.
- Inicialet e Cruise .
- Kufizojnë lëvizjet.




Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËNGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



Argëtim filozofik

- Krijesa më e rrezikshme e çdo shoqërie është njeriu i cili nuk ka asgjë për të humbur.
- Paratë gjithmonë kanë vlerën që i jep njeriu, asgjë më pak, asgjë më shumë. Vlera më e lartë dhe kapitali i vërtetë ka qenë, është dhe do të jetë njeriu.
- Nuk mund ta përcaktojmë lumturinë. Mund të flasim vetëm për atë që e shkatërron dhe për atë që e krijon.

Thënie të mënçura

- Njeriu në jetë është shpesh bagazh, të cilin e përdorin të tjerët.
- Më mirë është të njohësh njerëzimin në përgjithësi, se sa njeriun në veçanti.

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	8	5	7	4	2	3	9	1
1	7	9	5	3	8	4	6	2
2	3	4	6	9	1	5	8	7
3	5	2	4	8	6	7	1	9
7	9	8	2	1	3	6	4	5
4	6	1	9	5	7	8	2	3
5	4	3	1	6	9	2	7	8
8	1	7	3	2	4	9	5	6
9	2	6	8	7	5	1	3	4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

13	2	10	18	10	1	6	1	13	R	E	D	D	M	V	A	T	A	N				
17	6	11	6	7	18	2	12	5	2	E	P	I	S	O	D	E	T	N	A	T	O	
12	17	13	3	3	11	13	7	2	1	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T	M		
2	5	3	15	1	2	1	2	11	7	13	6	A	E	P	I	G	O	N	E	T	P	A
1	8	12	6	5	2	1	8	5	6	S	A	R	A	A	N	I	T	A	A	D		
10	7	11	6	5	2	4	6	1	7	13	P	G	T	V	G	O	R	A	R	E		
14	8	6	5	14	7	1	11	14	1	17	E	J	A	R	A	R	E	G	I			
12	2	5	1	7	7	7	11	7	5	5	K	E	S	T	E	K	I	T	I	M	O	
17	5	7	10	2	3	7	3	5	3	3	T	N	H	S	T	I	N	G	M	I	V	
4	2	10	6	11	2	8	0	5	7	E	T	A	H	A	N	G	A	R	I	I		
2	10	6	5	7	13	2	1	17	14	7	10	T	E	M	A	T	S	T	E	A	D	
1	6	5	6	11	6	1	13	2	18	7	T	I	P	I	E	D	I	T	O	R	I	

- Nuk gënjen vetëm ai që flet kundër asaj që di, por edhe ai që flet kundër asaj që nuk di.
- Sa më shumë bëni, aq më shumë mundeni.
- Gjërat e mira nuk vijnë për ata që presin.
- Gjërat e mira vijnë për ata që ndjekin qëllimet dhe ëndrrat e tyre.

